

UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS

RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Programi i Studimit me Karakter Profesional “Dizajn i Aplikuar dhe Modë”

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm:

1. Dr. Abaz Hado – Kryetar
2. MSc. Anila Zajmi Katanolli – Anëtar
3. MSc. Gejsi Tafa – Anëtar
4. Arba Neli – Studente

Prill 2021

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES VLERËSIMI TË BRENDSHËM

Programi i studimit me karakter profesional në “Dizajn i Aplikuar dhe Modë”, është hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë (UMASR) Nr. 555, datë 11.09.2018¹ “Për hapjen e programit të studimit me karakter profesional në “Dizajn i Aplikuar dhe Modë” në Universitetin European të Tiranës”.

Në përputhje me pikën 2 të UMASR Nr. 555, datë 11.09.2018, programi i studimit filloi veprimtarinë akademike në vitin akademik 2018-2019 dhe është në proces akreditimi për herë të parë. Programi ofrohet nga Departamenti i Arteve të Aplikuara, njësi bazë në Fakultetin e Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, sipas përcaktimeve të Urdhërit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 528, datë 04.09.2018², “Për riorganizimin e njësisë kryesore “Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit”, në “Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale”, në Universitetin European të Tiranës”.

Programi i studimit realizohet me 120 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë Profesionale” në “Dizajn i Aplikuar dhe Modë”.

Objektivi kryesor i këtij programi është formimi i ekspertëve dhe specialistëve në fushën e Dizajnit të Aplikuar dhe Modës duke i pajisur ata me njohuritë themelore teorike, me praktikat bashkëkohore ndërkombëtare si dhe në sajë të përvojës shqiptare dhe praktikave më të mira që përdoren në këtë fushë, të cilat me zhvillimin e ekonomisë shqiptare janë prezente dhe në vendin tonë, në aspektet teorike, praktiko-aplikative në fushën e dizajnit të aplikuar dhe modës. Studentët marrin njohuri të thelluara në këto disiplina, gjë e cila u mundëson atyre të jenë më të përgatitur me kriteret për punësim që kërkohen në këtë sektor. Pjesë e veprimtarive mësimore në fushën përkatëse është dhe puna kërkimore me karakter aplikativ dhe profesional, si përgjatë zhvillimit të lëndëve nëpërmjet përgatitjes së detyrave të kursit dhe përdorimit të literaturës, ashtu edhe përgjatë përgatitjes së Projektit Profesional.

Programi i studimit me karakter profesional, synon ta pajisë studentin me:

1. Njohuri dhe koncepte bazë të fushës së studimit;
2. Aftësi drejt një profesioni apo licence profesionale;
3. Formim qytetar të përgjithshëm;
4. Aftësi bazë për punë kërkimore aplikative;
5. Aftësi të përgjithshme praktike, aplikative;
6. Aftësim për promovim personal;
7. Projekt Profesional pa origjinalitet kërkimor por që dëshmon aftësitë e tij brenda profesionit të zgjedhur.

¹ Urdhër nr.555 dt.11.09.2018 “Për hapjen e programit të studimit me karakter profesional në “Dizajn i Aplikuar dhe Modë” në Universitetin European të Tiranës” (Ref. Nr. 54)

² UMASR Nr. 528, dt. 04.09.2018 “Për riorganizimin e njësisë kryesore “Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit”, në “Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale”, në Universitetin European të Tiranës”. (Ref. Nr. 54.2)

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Universiteti Europian i Tiranës, në përmbushje të detyrimeve ligjore, ka aplikuar me Shkresë Nr. 06/24, datë 30.04.2020, për akreditimin e programit të studimit.

Aplikimi është kryer pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), në përputhje me parashikimet e Manualit: *“Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit”*, i ndryshuar. Me kryerjen e aplikimit, UET mori masa me strukturat përkatëse për fillimin e procesit të vlerësimit të brendshëm. Rezultat i procesit të vlerësimit të brendshëm është ky Raport dhe dokumentacioni mbështetës, pjesë e Dokumentacionit të Vetë-Vlerësimit të programit (DVV).

Raporti është përgatitur nga një grup pune i ngritur me Urdhër të Rektorit, Nr. 02, datë 15.02.2021, në përputhje me dispozitat ligjore të MASR dhe ASCAL, si dhe me Statutin dhe Rregulloren e UET. Në përzgjedhjen e anëtarëve të grupit, është mbajtur parasysh kompetenca profesionale, përvoja mësimdhënëse, aftësitë analizuese, mundësitë për mbledhjen dhe për përpunimin e informacionit për të kryer një vlerësim të paanëshm, shkalla e nevojshme të njohjes së institucionit, si dhe profile individual profesional. Në punën për hartimin e këtij Raporti, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm ka vepruar me një ndarje pune, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për secilin anëtar. Në konsultim me personelin akademik, stafin administrativ dhe studentët e Universitetit Europian të Tiranës, anëtarët e Grupit të punës në analizën e tyre kanë vënë theksin në përmbajtjen akademike të programit, në ecurinë e personelit akademik përgjegjës për realizimin e tij, në vlerësimin e infrastrukturës dhe mjedisit në dispozicion, si edhe në parametra të tjerë me rëndësi për procesin e akreditimit të programit të studimit me karakter profesional në *“Dizajn i Aplikuar dhe Modë”*.

Grupi është bazuar në kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 *“Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”*, aktet ligjore e nënligjore përkatëse, në mënyrë të veçantë udhëzimet e ASCAL-it, si edhe ka shfrytëzuar dokumentet e brendshme të UET-it. Grupit i janë vënë në dispozicion dhe ka shfrytëzuar në mënyrë racionale të gjitha të dhënat statistikore që nevojiten për procesin e akreditimit periodik, të cilat janë përfshirë në Raport dhe që janë të strukturuar edhe në formën e tabelave dhe grafikëve.

Në mbështetje të këtij Raporti, bashkangjitur është edhe lista e dokumenteve bazë që kanë qënë të nevojshme për hartimin e tij në lidhje me procesin e akreditimit të parë të programit të studimit me karakter profesional në *“Dizajn i Aplikuar dhe Modë”*.

Ecuria e procesit është ndjekur nga Përgjegjësi i Departamentit dhe Zyra e Standardeve dhe Cilësisë, të cilët kanë asistuar GVB dhe kanë koordinuar procesin e mbledhjes së të dhënave. GVB ka zhvilluar takime të herëpashershme me të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces, takime të fokusuar në orientimet e nevojshme në lidhje me procesin e hartimit të raportit të vlerësimit të brendshëm, udhëzuesit dhe template-t për shkrimin e raportit. Gjatë takimit të parë u propozua dhe u miratua dhe plani i punës, me hapat dhe afatet deri në dorëzimin e draftit përfundimtar të raportit. Ndërsa, gjatë punës për hartimin e Raportit, janë reflektuar konstatime dhe plotësime nga aktorët e konsultuar në këtë proces.

Vlerësimi i Programit të Studimit me karakter profesional “Dizajn i Aplikuar dhe Modë”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Programi i studimit me karakter profesional në “Dizajn i Aplikuar dhe Modë”, është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit si dhe me fushën e veprimtarisë. Ky program studimi plotëson profilin dhe ofertën akademike të Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale. Ky program është i projektuar për ata që duan të studiojnë në fushën e Dizajnit të Aplikuar dhe Dizajnit të Modës. Programi përgatit specialistë të dizajnit, duke iu përgjigjur kërkesave aktuale dhe perspektive të tregut të punës në Shqipëri dhe më gjerë ³ .
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Drejtimit prioritar akademike janë të përcaktuara në dokumentet themelore të institucionit. Në këto dokumente shprehet fakti se UET synon ruajtjen e profilizimit të tij kryesor në shkencat ekonomike, financiare, menaxheriale, jurisprudencës, shkencave politike e sociale, edukimit, sporteve, TIK-ut, arkitekturës, inxhinierive, komunikimit, shkencave mjekësore teknike, etj., por mbetet i hapur ndaj diversifikimit të ofertës së tij akademike e shkencore dhe në drejtime të tjera që vlerësohen se kërkohen nga tregu i punës dhe UET ka mundësitë njerëzore e financiare për t’i aplikuar ato ⁴ . Gjithsesi në dekadën e tij të dytë, Institucioni ka vendosur zgjerimin e fushave të studimit në të cilat ofron programe studimi, siç është fusha e arteve në drejtimit arte pamore, arte skenike dhe arte muzikore dhe programet e studimit të ofruara në Departamentin e Arteve të Aplikuara ⁵ , duke akomoduar më mirë kërkesat që vijnë nga studentët por edhe tregu i punës ⁶ .
Kriteri 3. Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësisë kryesore/kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin e	Programi i studimit me karakter profesional në “Dizajn i Aplikuar dhe Modë”, është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit si dhe me fushën e drejtimit akademike të UET. Ky program studimi

³ Rregullore e programit të studimit DP Dizajn i Aplikuar dhe Modë, Pika 3.3; Aneks (Ref. Nr. 7)

⁴ Plani Strategjik 2015-2020, Objektivat strategjik (Ref. Nr. 3)

⁵ Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga njësi përgjegjëse (Ref. Nr. 26)

⁶ Argumentimi për hapjen e programit; Analiza e DAA e tregut të punës para hapjes: Prespektiva punësimi (Ref. Nr. 16; 16.1)

studimit.	plotëson profilin dhe ofertën akademike të Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale. Fusha e këtij programi është në përputhje të plotë me fushën dhe drejtimet akademike në njësinë kryesore dhe njësinë bazë përgjegjëse për programin e studimit.			
Kriteri 4. Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.	Përpara hapjes së programit të studimit me karakter profesional në “Dizajn të Aplikuar dhe Modë”, është realizuar një vëzhgim i tregut të punës, i cili ka shërbyer si bazë për të përcaktuar përmbajtjen e kurrikulës dhe profilizimet e programit ⁷ . Drejtuksi i Departamentit është përgjegjës për mbajtjen e marrëdhënieve me Bordin e Tregut të punës (BTP) ⁸ dhe për tërheqjen e kontributit të anëtarëve të Bordit. Bordi mbledhet së paku dy herë në vit për të konsultuar përputhshmërinë e përmbajtjes së programeve të studimit me kërkesat e tregut të punës dhe për të analizuar ecurinë e zhvillimit të praktikave dhe veprimtarive të tjera që lidhen me daljen e studentëve në tregun e punës.			
Kriteri 5. Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve.	Në UET është ngritur shoqata UET ALUMNI, e cila mban kontakte me studentët e diplomuar të programeve të studimit, duke përpunuar të dhënat statistikore me shkallën e punësimit të tyre. Studentët kontaktohen në periudhën mars-maj të çdo viti (së paku 6 muaj pas diplomimit). Si rregull, studimet periodike të tregut të punës, kryhen nga Departamenti pas diplomimit të brezit të parë të studentëve. ⁹			
Kriteri 6. Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	UET konsultohet me përfaqësues të bizneseve, të shërbimeve ose profesioneve përkatëse, të organizuar në formën e Bordeve të Tregut të Punës ¹⁰ në nivel Departamenti, për t’ju përgjigjur sa më mirë dhe në kohë kërkesave të tregut të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

⁷ Analizë e DAA e tregut të punës para hapjes: Prespektivat e punësimit; Argumentimi i hapjes (Ref. Nr. 16.1; 16)

⁸ Bordi i Tregut të Punës (Ref. Nr. 12.1); Takime_aktivitete Bordi i Tregut të Punës (Ref. Nr. 12.4)

⁹ Studimi periodic për tregun e punës (Ref. Nr. 17)

¹⁰ Statuti i UET, Neni 18, pika 18.3 (Ref. Nr. 2)

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Ndarja e detyrave dhe përgjegjësive në hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit është e përcaktuar në rregulloret dhe aktet e tjera të brendshme të institucionit ¹¹ . Detyrat dhe përgjegjësitë ndahen midis njësisë të ndryshme, por pesha kryesore mbulohet nga njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit. Në aktet rregullatorë janë të përcaktuara qartë roli i përgjegjës të njësisë bazë, përgjegjës të grup-lëndëve sikurse dhe ato të titullarit të lëndëve specifike.
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, me punëdhënës vendës, aktorë të biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Në kuadër të realizimit të objektivave e procesit mësimor të programit me karakter profesional në “Dizajn i Aplikuar dhe Modë”, institucioni ka bashkëpunuar dhe ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë dhe institucione vendase, ku realizimi i praktikave profesionale mbetet një ndër komponentët kryesor, së bashku me krijimin e lidhjeve midis universitetit dhe aktorëve të tregut të punës, në funksion të punësimit të studentëve, por edhe për të qenë më pranë nevojave të tregut të punës dhe reflektimit të tyre në programin e studimit ¹² .
Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësi përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Në fund të çdo viti akademik, në UET praktikat vlerësohen nga një komision i posaçëm dhe nga vetë studentët me anë të një formulari ¹³ ku merret një feedback për efektshmërinë e realizimit të tyre, dhe ku mund të punohet më tej në përmirësimin e praktikave. Marrëveshjet e bashkëpunimit ¹⁴ në kuadër të realizimit të programit, zbatohen në kuadër të zhvillimit të praktikave profesionale për studentet e vitit të dytë, gjatë semestrit të dytë të vitit të fundit të studimeve ¹⁵ .
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	Përveç parashikimeve në marrëveshjet e bashkëpunimit apo në marrëdhëniet me institucionet ku studentët kryejnë praktikën, procedurat e zhvillimit të praktikave profesionale janë të rregulluara edhe nëpërmjet akteve të brendshme, në të cilat janë parashikuar si procedurat që duhet të ndiqen ashtu edhe roli i aktorëve dhe njësisë të ndryshme të përfshira në këtë proces ¹⁶ .

¹¹ Rregullore e UET, Neni 16-18, 21-22 (Ref. Nr. 5); Dokumenti F.IV - F.V: Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit (Ref. Nr. 6)

¹² Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit (Ref. Nr. 32); ANEKS: Tabelat përmbledhëse – Tabelat 5

¹³ Format i B.I.4 Formulari i vetvlerësimit të praktikës profesionale nga student (Ref. Nr. 32.2)

¹⁴ Marrëveshjet e bashkëpunimit (Ref. Nr. 34.1-34.7)

¹⁵ Kurrikula e programit të studimit DP Dizajn i Aplikuar dhe Modë (Ref. Nr. 14)

¹⁶ Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale (Ref. Nr. 32.1); ANEKS : Tabelat përmbledhëse – Tabela 5.3 « Të dhëna për realizimin e praktikave profesionale »

Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.	Për shkak të Pandemisë COVID-19, UET nuk ka ofruar ndonjë trajnim specifik profesional për studentët e këtij programi gjatë vitit aktual akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit është organizuar në lëndë dhe module, të vlerësuara me kredite, në përputhje me udhëzimet e MASR, me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të transferimit dhe Grumbullimit të Kreditve. Lëndët e thjeshta të këtij programi janë të vlerësuara me nga 4 deri në 6 kredite (ECTS), duke bërë që në total ky program studimi me karakter profesional të këtë 120 ECTS ¹⁷ .
Kriteri 2. Programet e studimeve me karakter profesional synojnë përfundimin e njohurive gjithë përfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh.	Programi i studimit ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve, duke përfshirë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale me të cilat pajiset studenti në përfundim të tij. Programi i studimit është i organizuar në mënyrë të tillë që studenti të marrë formimin e duhur, kryesisht praktik, për arritjen e objektivave profesionale me qëllim në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh në fushën e dizajnit të aplikuar dhe modës ¹⁸ . Objektivat programit të studimit, si edhe mundësitë e punësimit përcaktohen në rregulloren e programit të studimit ¹⁹ .
Kriteri 3. Programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.	Programi i studimit synon të pajisë studentët me njohuri të thella, të formojë specialistë në aspektet praktike aplikative në fushën e Dizajnit të Aplikuar dhe Modës. Ndër objektivat kryesorë të programit mund të përmendim pajisjen e studentëve me njohuritë themelore teorike, praktikat bashkëkohore e ndërkombëtare dhe përvojën e eksperiencën shqiptare dhe të huaj në fushën e Dizajnit të Aplikuar dhe Modës. Për nga vetë specifika e programit, studentët mësojnë se si t'ju qasen sfidave të ndryshme krijueseve si në konceptim, ashtu edhe në ekzekutim apo implementim të projektit nëpërmjet metodave praktike të punës në këtë fushë. Kjo gjë reflektohet në lëndët që studentët ndjekin sipas kurrikulës së programit të studimit. ²⁰

¹⁷ Kurrikula e programit të studimit DP Dizajn i Aplikuar dhe Modë (Ref. Nr. 14)

¹⁸ Rregullore e programit të studimit DP Dizajn i Aplikuar dhe Modë, Pika 3.1 (Ref. Nr. 7)

¹⁹ Rregullore e programit të studimit DP Dizajn i Aplikuar dhe Modë, Pika 3.3 & Aneks I (Ref. Nr. 7)

²⁰ Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese DP Dizajn i Aplikuar dhe Modë (Ref. Nr. 14.2)

<p>Kriteri 4. Programet e studimit me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme.</p>	<p>Siç reflektohet edhe në silabuset e lëndëve, programi ka për qëllim zhvillimin e aftësive individuale krijuese dhe aplikative, si dhe të zhvillojë aftësitë komunikuese dhe bashkëpunuese në grup me profesionistë të tjerë. Duke u përballur me detyrat e lëndëve përkatëse, studentët përftojnë aftësi të të punuarit në mënyrë autonome dhe përgatiten me sfidat që hasin në rrugëtimin e tyre profesional.²¹</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni/njësia kryesore/kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik.</p>	<p>Personeli akademik gëzon status të veçantë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si edhe në aktet rregullatorë të UET.</p> <p>Personeli akademik në UET kryen veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, shërbime për mbështetje dhe zhvillim të UET, këshillim për studentët, tutoriat si dhe veprimtari të tjera.²²</p> <p>Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës.</p> <p>Ngarkesa e plotë mësimore për personelin akademik në UET përcaktohet nga aktet rregullatorë të UET, në përputhje me përcaktimet ligjore.</p> <p>Stafi akademik i njësisë bazë përbëhet nga 17 profesorë në punësim me kohë të plotë, nga të cilët: 3 me titullin akademik Prof. Dr., 2 me titullin akademik Prof. As. Dr., 2 me gradë shkencore “Doktor” dhe 10 asistentë lektorë me kualifikimin “Master i Shkencave”. Personel akademik me kontratë të angazhuar pranë njësisë bazë, janë 11, nga të cilët 2 me titull akademik Prof. Dr., 1 me gradë shkencore “Doktor”, ndërsa 1 në proces të mbrojtjes së kësaj grade dhe 7 asistentë lektorë me kualifikimin “Master i Shkencave”. Këto të dhëna janë tregues i përmbushjes së kriterëve dhe standardeve ligjore lidhur me numrin dhe kualifikimin e personelit akademik të njësisë bazë, njësisë kryesore dhe Institucionit²³.</p>			
<p>Kriteri 6. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p>	<p>Programi i studimit ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve, duke përfshirë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale me të cilat pajiset studenti në përfundim të tij. Programi i studimit është i organizuar në mënyrë të tillë që studenti të marrë formimin e duhur, kryesisht praktik, për arritjen e objektivave profesionale me qëllim punësimin me përfundim të studimeve²⁴. Objektivat formuese dhe karakteristikat e programit të studimit, si edhe mundësitë e punësimit përcaktohen në rregulloren e programit të studimit²⁵.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Nuk</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet</p>

²¹ Planet lëndore (silabuset) DP Dizajn i aplikuar dhe mode (Ref. Nr. 19)

²² Statuti i UET, Neni 42 (Ref. Nr. 2)

²³ Të dhëna tabelore për personelin akademik të fakultetit (Aneks_Tabela 1 dhe 2) (Ref. Nr. 23)

²⁴ Rregullore e programit të studimit DP Dizajn i Aplikuar dhe Modë, Pika 3.1 (Ref. Nr. 7)

²⁵ Rregullore e programit të studimit DP Dizajn i Aplikuar dhe Modë, Pika 3.3 & Aneks I (Ref. Nr. 7)

standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1	
<p>Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit</p>	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programet e studimit me karakter profesional, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formuese, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe.</p>	<p>Në Rregulloren e programit të studimit janë të përcaktuara qartë informacionet e nevojshme për objektivat formuese, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimit²⁶, përmbajtjes dhe fushat reale të punësimit të studentëve. Në Rregulloren e programit përcaktohet se ai synon ta pajisë studentin me:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Njohuri dhe koncepte bazë të fushës së studimit 2. Aftësi drejt një profesioni apo licence profesionale 3. Formim qytetar të përgjithshëm 4. Aftësi bazë për punë kërkimore 5. Aftësi të përgjithshme praktike, aplikative 6. Aftësim për promovim personal 7. Projekt profesional pa origjinalitet kërkimor por që dëshmon si është kuptuar puna e studiuesve të tjerë në fushën përkatëse²⁷. <p>Fushat reale të punësimit të studentëve janë: a. Stilist i veshjeve të ndryshme si biznes privat; b. Stilist i veshjeve të shfaqjeve të ndryshme në institucione artistike dhe kulturore qendrore dhe vendore; c. Krijues logosh dhe emblemash për individë dhe biznese si pjesë e veprimtarisë private; d. Dekorues i ambjenteve të hapura dhe të mbyllura publike apo private.²⁸</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit janë të organizuara në module/lëndë e aktivitete</p>	<p>Programi i studimit është organizuar në lëndë dhe</p>

²⁶ Kurrikula e programit DP Dizajn i Aplikuar dhe Modë (Ref. Nr. 14)

²⁷ Rregullore e programit të studimit DP Dizajn i Aplikuar dhe Modë, Pika 3.3 (Ref. Nr. 7)

²⁸ Rregullore e programit të studimit DP Dizajn i Aplikuar dhe Modë, Aneks (Ref. Nr. 7)

<p>formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi.</p>	<p>aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, në përputhje me udhëzimet e MASR, me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të transferimit dhe Grumbullimit të Kreditive. Lëndët e këtij programi janë të vlerësuara me nga 4 deri në 6 kredite (ECTS), duke bërë që në total ky program studimi me karakter profesional të këtë 120 ECTS²⁹.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.</p>	<p>Parimi themelor i ndërtimit të programit të lëndës shtrihet në të gjithë strukturën pedagogjike dhe shkencore të lëndës ku përfshihet: përmbajtja e njohurive, metoda pedagogjike, bibliografia dhe kontrolli i njohurive³⁰. Struktura e programit të lëndës për programet me karakter profesional përmban: informacionin e përgjithshëm i cili në thelb përcakton: emërtimin e lëndës, emrin e pedagogut të lëndës, firmën, ngarkesën (numri i krediteve, numri i orëve mësimore në klasë), tipologjinë e lëndës, semestrin kur zhvillohet lënda, llojin e lëndës (e detyrueshme ose opsionale), programin e studimit ku ofrohet kjo lëndë, kodin e lëndës, adresën elektronike të pedagogut të lëndës dhe miratimin e Përgjegjës të grup-lëndës dhe Përgjegjës të Departamentit përkatës.³¹</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përmbledhja dhe qëllimet e kursit. • Konceptet themelore çelës, koncepte e terma bazë mbi të cilat ndërtohet lënda. • Temat e leksionit. • Format e kontrollit të dijeve, format e vlerësimit të studentëve, të shprehura si përqindje e notes përfundimtare, siç janë niveli i diskutimit në seminare, kolokiumi, provimi i ndërmjetëm, detyra e kursit dhe provimi përfundimtar, etj si edhe literature, literaturë e rekomanduar dhe literature bazë. <p>Plani mësimor për programin e studimit hartohet me përbërësit specifikë sipas kuadrit ligjor në fuqi³². Kurrikula aktuale dhe pesha e aktiviteteve formuese është miratuar me hapjen e programit të studimit, përpara hyrjes në fuqi të ndryshimeve në VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018.³³ Ky fakt shpjegon shmangien e përqindjeve të parashikuara në nryshimet e VKM, ndërsa rezulton se plotësohet kriteri i balancimit të përmbajtjes praktike/teorike të programit.³⁴ Frekuentimi i procesit</p>

²⁹ Kurrikula e programit të studimit DP Dizajn i Aplikuar dhe Modë; Plani mësimor (Ref. Nr. 14; 14.1)

³⁰ Mbi parimet e ndërtimit të lëndës (Ref. Nr. 39)

³¹ Planet lëndore (silabuse) (Ref. Nr. 19)

³² Plani mësimor (Ref. Nr. 14.1)

³³ Kurrikula e programit të studimit (veprimtaritë formuese sipas dokumentit të hapjes) (Ref. Nr. 14); Plani mësimor sipas veprimtarive formuese A-E (sipas ndryshimeve të VKM 41, Dhjetor 2018) (Ref. Nr. 14.2)

³⁴ Plani mësimor sipas veprimtarive me karakter teorik v.s. praktik (Ref. Nr. 14.3)

	<p>mësimor (leksione, leksion/seminar, seminare) në programet e studimit me karakter profesional është i detyrueshëm në masën 60%, kurse frekuentimi i orëve në laborator dhe praktika mësimore, është i detyrueshëm në masën 100%.³⁵</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikatat, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktivitetet formuese të programit të studimit.</p>	<p>Disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në 5 kategori, nga A – ja deri te E – ja. Në kategorinë A bëjnë pjesë disiplina të formimit të përgjithshëm/bazë, në kategorinë B disiplina të formimit karakterizues të programit, në kategorinë C disiplina të formimit profesional, në kategorinë D veprimtari formuese për njohje të gjuhëve të huaja, aftësi kompjuterike dhe praktika profesionale. Në kategorinë E janë Detyrime përmblylëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose me provimin përfundimtar.³⁶ Programi i studimit dhe plani mësimor i bashkëlidhet si shtojcë rregullore mësimore dhe publikohen çdo fillim viti akademik. Programet e studimit të detajuar me lëndët dhe modulet që përmban, i jepet studentit që në momentin e regjistrimit. Gjithashtu gjendet edhe në faqen e internetit të UET. Në fillim të çdo semestri, studentëve u vihet në dispozicion programi i të gjitha lëndëve që do të zhvillohen, ku janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar, ngarkesa, temat për çdo javë mësimore, literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar për secilën temë, format e kontrollit dhe vlerësimit, niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës dhe literatura bazë dhe ajo e rekomanduar.</p> <p>Programi i studimit me karakter profesional në Dizajn të Aplikuar dhe Modë ndjek politikat institucionale të UET në raport me standardin e syllabusve. Përgjegjës për hartimin e syllabusit, sipas modelit të miratuar në licencimin e programit është pedagogu. Sipas Statutit të institucionit, “përpara fillimit të çdo viti akademik, Bordet e Tregut të Punës konsultojnë programet e studimit dhe planet mësimore, për të garantuar përputhjen e tyre me kërkesat e tregut të punës”.³⁷ Syllabuset janë të detajuar dhe përmbajnë të dhënat faktike mbi lëndën (pedagogu, kontakti i tij, ngarkesa mësimore, ngarkesa në ECTS, vitin akademik, departamentin dhe fakultetin, si edhe personin përgjegjës në to); një përmbledhje dhe, në disa raste, qëllimet e kursit; konceptët themelore që preken në</p>

³⁵ Rregullore e UET, Neni 25 (Ref. Nr. 5); Planet lëndore (silabuset) (Ref. Nr. 19)

³⁶ Kurrikula e programit të studimit (Ref. Nr. 14); Plani mësimor i programit (Ref. Nr. 14.1); Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (Ref. Nr. 14.2); Silabuset e lëndëve (Ref. Nr. 19)

³⁷ Statuti UET, Neni 18.4.1 (Ref. Nr. 2)

	lëndë; temat e kursit, mënyrën e kontrollimit të vazhdueshëm, literaturën e lëndës dhe politikën e saj. ³⁸			
Kriteri 5. Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.	Programi i studimit ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve, duke përfshirë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale me të cilat pajiset studenti në përfundim të tij. Programi i studimit është i organizuar në mënyrë të tillë që studenti të marrë formimin e duhur, kryesisht praktik, për arritjen e objektivave profesionale me qëllim punësimin. Objektivat formuese dhe karakteristikat e programit të studimit, si edhe mundësitë e punësimit përcaktohen në rregulloren e programit të studimit ³⁹ .			
Kriteri 6. Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.	Kontrolli i vazhdueshëm, detyrat praktike gjatë seminarit, rrisin mundësinë për të kuptuar nëse studentët po i arrijnë objektivat mësimore. Për të pasur një transmetim dhe përvetësim sa më të mirë të njohurive procesi mësimor zhvillohet me leksione, me seminare, leksion/seminare, me detyra praktike dhe me detyra kursi, punim diplome, provim të përgjithshëm përfundimtar, etj. Kontrolli i dijeve ⁴⁰ është i vazhdueshëm, përgjatë gjithë semestrit, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të identifikojnë mangësitë dhe t'i plotësojnë ato përpara përfundimit të semestrit. Vetë struktura e programit mbart lëndë praktike të cilat janë vlerësuar me 6 kredite ECTS. Këto janë lëndë thelbësore në ushtrimin dhe praktikën e profesionit si dhe në formimin e studentëve si profesionistë të së ardhmes.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënies sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja e në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në 5 kategori, nga A – ja deri te E – ja. Në kategorinë A bëjnë pjesë disiplina të formimit të përgjithshëm/bazë, në kategorinë B disiplina të formimit karakterizues të programit, në kategorinë C

³⁸ Silabusët e lëndëve (Ref. Nr. 19)

³⁹ Rregullore e programit të studimit DP Dizajn i Aplikuar dhe Modë, Pika 3.3 & Aneks I (Ref. Nr. 7)

⁴⁰ ANEKS: Tabelat përmbledhëse – Tabela Nr. 15 “Format e kontrollit të njohurive”

	<p>disiplina të formimit profesional, në kategorinë D veprimtari formuese për njohje të gjuhëve të huaja, aftësime kompjuterike dhe praktika profesionale. Në kategorinë E janë Detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e projekti aplikativ profesional ose me provimin përfundimtar. Përfundimi me sukses i programit të studimit e çon studentin në tregun e punës ose i jep mundësi atij për njohjen/transferimin e krediteve të grumbulluara gjatë studimeve profesionale të larta në studimet universitare të ciklit të parë që referohet në Nivelin 6 të KSHK.</p> <p>Emërtesat, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave⁴¹ mundësojnë konstruktimin e njohurive, aftësive duke kontribuar në punësimin e studentëve. Para se të aplikohet për licencim, kurrikulat janë konsultuar si me pedagogë, ashtu edhe me aktorët e tregut të punës. Kur Departamenti i Arteve të Aplikuara gjykon të nevojshme të bëhet një ndryshim në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të programit të studimit nën vlerësimin për akreditim, e ndërmerret atë në përputhje me kriteret ligjore të parashikuara dhe aktet rregullatore të UET.⁴² Shpërndarja e lëndëve ndjek logjikën e avancimit nga lëndët bazë të formimit të përgjithshëm, në lëndë me karakter praktik. Shpërndarja e krediteve nëpër vitet është normale, total në vitin e parë 61 ECTS, total në vitin e dytë 59 ECTS.⁴³</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>Gjatë një viti akademik, organizimi i veprimtarisë mësimore shtrihet në 2 (dy) semestra me kohëzgjatje normale 14 javë⁴⁴. Studimet në këtë program janë së paku me 120 ECTS. Ngarkesa vjetore është 60 ECTS, e ndarë pothuajse në mënyrë të barabartë 30 ECTS, për çdo semestër, konform legjislacionit në fuqi.⁴⁵ Kjo ndarje, mundëson arritjen e rezultateve të pritshme të të nxëniet. ⁴⁶ Gjithashtu, kontrolli i vazhdueshëm, detyrat praktike gjatë seminarit, rrisin mundësinë për të kuptuar nëse studentët po i arrijnë objektivat mësimore.⁴⁷</p>

⁴¹ Plani mësimor i programit (Ref. Nr. 14.1); Silabuset e lëndëve (Ref. Nr. 19)

⁴² Dokumenti E.VIII Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave (Ref. Nr. 13)

⁴³ Plani mësimor i programit (Ref. Nr. 14.1)

⁴⁴ Kalendari akademik (Ref. Nr. 10.3)

⁴⁵ Plani mësimor i programit (Ref. Nr. 14.1)

⁴⁶ Analiza e departamentit përgjegjës (Ref. Nr. 38)

⁴⁷ Analiza e departamentit përgjegjës (Ref. Nr. 38)

	<p>Programi i studimit është i organizuar në mënyrë të tillë që studenti të marrë formimin dhe kompetencat e duhura, kryesisht praktike, për arritjen e objektivave profesionale me qëllim punësimin e studentëve.</p> <p>Kështu, Programi i studimit, synon ta pajisë studentin me⁴⁸:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Njohuri dhe koncepte bazë të fushës së studimit; 2. Aftësi drejt një profesioni apo licence profesionale; 3. Formim qytetar të përgjithshëm; 4. Aftësi bazë për punë kërkimore aplikative; 5. Aftësi të përgjithshme praktike, aplikative; 6. Aftësim për promovim personal; 7. Projekt Profesional pa origjinalitet kërkimor por që dëshmon aftësitë e tij brenda profesionit të zgjedhur.
<p>Kriteri 3. Plani mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve, syllabuset e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara.</p>	<p>Programi i studimit, plani mësimor, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program, si dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë periodike, në përputhje me parashikimet në aktet nënligjore dhe aktet rregullatore të UET. Ndryshimet propozohen nga Departamenti, Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave, por edhe nga anëtarë të personelit akademik, në konsultim me Bordet e Tregut të Punës, si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme. Propozimi për ndryshime në çdo rast vjen i argumentuar nga personi i interesuar. Ai shqyrtohet në Departament dhe nga Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave dhe pastaj dërgohet për miratim në mbledhjen e Dekanatit.⁴⁹</p> <p>Rishikimi mund të bëhet vetëm para fillimit të vitit akademik dhe jo në mes të vitit akademik apo pasi ai të ketë filluar. Në çdo rast, ndryshimet nuk mund të jenë të tilla që të devijojnë nga formimi i kërkuar për fushën përkatëse të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion.</p>	<p>Parimi themelor i ndërtimit të programeve është parimi i rrathëve, i cili ka si qëllim lehtësojë përshtatjen e studentëve që vijnë nga programe të ndryshme studimi, brenda ose jashtë UET-it, në një program studimi të një cikli universitar; plotësimi i</p>

⁴⁸ Rregullore mësimore e programit të studimit (Ref. Nr. 7)

⁴⁹ Dokumenti E.VIII Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave (Ref. Nr. 12)

	<p>njohurive për studentët që i përfundojnë studimet në një tërësi nga ciklet dhe nuk vazhdojnë më tej studimet e tyre.⁵⁰ Struktura e programit, emërtimet dhe përmbajtja e lëndëve, ngarkesa e tyre në kredite, raporti teori praktikë janë në përputhje me profilin e programit me karakter profesional⁵¹ dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p>Në fakt, ky kriter nuk ka qënë i përcaktuar në kërkesat e Ministrisë së Arsimit në momentin e aplikimit për licencimin e programit të studimit.⁵² Gjithsesi, nga analiza e përmbajtjes së moduleve dhe aktiviteteve të ofruara nga kurrikula e programit rezulton se raporti mes formimit teorik dhe praktik është 45:55 (nëse përlllogaritet në bazë të krediteve) dhe 46:54 (nëse përlllogaritet në bazë të orëve në auditor), në të dyja rastet në favor të formimit praktik.⁵³</p> <p>Gjithashtu, kurrikula rezulton se përmbush edhe kriterin që rreth 25% e programit i ofron studentit aftësim praktik/punë konkrete në profesion. Sikurse është pasqyruar në relacion (evidenca mbështetëse me nr. 14.3 “Plani mësimor sipas veprimtarive formim teorik_praktik”), 29.25 kredite ECTS (ose 24.4%) e programit përbëhet nga veprimtari të aftësimit praktik/punë konkrete në profesion.⁵⁴</p>			
<p>Kriteri 5. Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Bazuar në Planin mësimor të programit dhe planeve lëndore sipas aktivitetit formues, lëndët në bërthamën e disiplinës shpërndajnë orët e punës më shumë në drejtim të praktikës dhe kontekstualizimit të dijeve teorike, në mënyrë që t’i pajisin studentët me aftësitë dhe kompetencat të vlefshme për punësim.⁵⁵ Theksojmë programi i studimit synon t’i aftësojë studentët të lundrojnë vetë në dijen e disiplinës dhe duke i ‘mësuar si të mësojnë’.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

⁵⁰ Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të lëndës, Pika A.III.4 (Ref. Nr. 39)

⁵¹ Plani mësimor i programit (Ref. Nr. 14.1); Plani mësimor sipas veprimtarive me karakter teorik v.s. praktik (Ref. Nr. 14.3)

⁵² Urdhër MASR Nr. 555, dt. 11.09.2018 “Per hapjen e programit DP Dizajn i Aplikuar dhe Mode” (Ref. Nr. 54)

⁵³ Plani mësimor sipas veprimtarive me karakter teorik v.s. praktik (Ref. Nr. 14.3)

⁵⁴ Plani mësimor sipas veprimtarive me karakter teorik v.s. praktik (Ref. Nr. 14.3)

⁵⁵ Plani mësimor i programit (Ref. Nr. 14.1); Silabuset e lëndëve (Ref. Nr. 19)

Standardi II.3

Përmbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxëniet dhe kërkesat e tregut të punës për këto programe

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktiviteteve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.</p>	<p>Disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në 5 kategori, nga A – ja deri te E – ja. Në kategorinë A bëjnë pjesë disiplina të formimit të përgjithshëm/bazë, në kategorinë B disiplina të formimit karakterizues të programit, në kategorinë C disiplina të formimit profesional, në kategorinë D veprimtari formuese për njohje të gjuhëve të huaja, aftësi kompjuterike dhe praktika profesionale. Në kategorinë E janë Detyrime përmblyëse, që lidhen me përgatitjen e projektit aplikativ profesional ose me provimin përfundimtar. Programi i studimit ofron mundësinë e profilizimit. Programi i studimit dhe plani mësimor i bashkëlidhet si shtojcë rregullore mësimore dhe publikohen çdo fillim viti akademik. Programet e studimit të detajuar me lëndët dhe modulet që përmban, i jepet studentit që në momentin e regjistrimit. Gjithashtu gjendet edhe në faqen e internetit të UET. Në fillim të çdo semestri, studentëve u vihet në dispozicion programi i të gjitha lëndëve që do të zhvillohen, ku janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar, ngarkesa, temat për çdo javë mësimore, literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar për secilën temë, format e kontrollit dhe vlerësimit, niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës dhe literatura bazë dhe ajo e rekomanduar.⁵⁶</p> <p>Programi i studimit me karakter profesional në “Dizajn i aplikuar dhe Modë” ndjek politikën institucionale të UET në raport me standardin e syllabusve. Përgjegjës për hartimin e syllabusit, sipas modelit të miratuar në licensimin e programit është pedagogu.⁵⁷ Sipas Statutit të institucionit, “përpara fillimit të çdo viti akademik, Bordet e Tregut të Punës konsultojnë programet e studimit dhe planet mësimore, për të garantuar përputhjen e tyre me kërkesat e tregut të punës”.⁵⁸ Syllabuset janë të detajuar dhe përmbajnë të dhënat faktike mbi lëndën (pedagogu, kontakti i tij, ngarkesa mësimore, ngarkesa në ECTS, vitin akademik, departamentin dhe fakultetin, si edhe personin përgjegjës në to); një përmbledhje dhe, qëllimet e kursit;</p>

⁵⁶ Rregullorja e programit të studimit (Ref. Nr. 7)

⁵⁷ Format i silabusit (Ref. Nr. 19.1)

⁵⁸ Statuti UET, Neni 18.4.1 (Ref. Nr. 2)

	konceptët themelore që preken në lëndë; temat e kursit, mënyrën e kontrollimit të vazhdueshëm, literaturën e lëndës dhe politikat e saj ⁵⁹
Kriteri 2. Përmbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehite e kërkuara/të pritshme nga punëdhënësit.	Objektivi kryesor i këtij programi është formimi i ekspertëve dhe specialistëve në fushën e Dizajnit të Aplikuar dhe Modës të cilat me zhvillimin e ekonomisë shqiptare janë prezente dhe në vendin tonë, në aspektet teorike, praktike dhe aplikative në fushën e arteve pamore, pajisja e tyre me njohuritë themelore teorike, praktikat bashkëkohore ndërkombëtare dhe përvojën e eksperiencën shqiptare dhe praktikave më të mira që përdoren në këtë fushë. Studentët marrin njohuri të thelluara në artet pamore, gjë e cila u mundëson atyre të jenë më të përgatitur me kriteret për punësim që kërkohen në këtë sektor. Në mënyrë më specifike, studentët, në varësi me preferencat dhe strategjinë e karrierës së tyre, kanë mundësi të zgjedhin e të orientohen në një nga katër profilet e ofruara në këtë program studimi.
Kriteri 3. Përmbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përmbajtjen e tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.	Programi i studimit synon të pajisë studentët me njohuri të thella, të formojë ekspertë dhe specialistë si në aspektet teorike ashtu edhe në aftësitë praktike aplikative në fushën e Arteve Pamore. Ndër objektivat kryesorë të programit mund të përmendim pajisjen e studentëve me njohuritë themelore praktike, praktikat bashkëkohore e ndërkombëtare dhe përvojën e eksperiencën shqiptare dhe të huaj në fushën e Arteve Pamore.
Kriteri 4. Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/punë konkrete mundësojnë përfitim të njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.	Objektivi kryesor i këtij programi është formimi i ekspertëve dhe specialistëve në fushën e Arteve Pamore, të cilat me zhvillimin e ekonomisë shqiptare janë prezente dhe në vendin tonë, në aspektet teorike, praktike dhe aplikative në fushën e arteve pamore, pajisja e tyre me njohuritë themelore teorike, praktikat bashkëkohore ndërkombëtare dhe përvojën e eksperiencën shqiptare dhe praktikave më të mira që përdoren në këtë fushë. Studentët marrin njohuri të thelluara në artet pamore, gjë e cila u mundëson atyre të jenë më të përgatitur me kriteret për punësim që kërkohen në këtë sektor.
Kriteri 5. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.	Përveç parashikimeve në marrëveshjet e bashkëpunimit ⁶⁰ apo në marrëdhëniet me institucionet ku studentët kryejnë praktikën, procedurat e zhvillimit të praktikave profesionale janë të rregulluara edhe nëpërmjet akteve të brendshme, në të cilat janë parashikuar si procedurat që

⁵⁹ Silabuset e lëndëve (Ref. Nr. 19)

⁶⁰ Marrëveshjet e bashkëpunimit (Ref. Nr. 34.1 – 34.12)

	duhet të ndiqen ashtu edhe roli i aktorëve dhe njësive të ndryshme të përfshira në këtë proces ⁶¹ .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

⁶¹ Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale (Ref. Nr. 32.1) ; ANEKS : Tabelat përmbledhëse – Tabela 5.3 Të dhëna mbi realizimin e praktikave mësimore

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikat më të mira të fushës	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngrre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike.</p>	<p>Në kuadër të politikave të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies UET ka hartuar udhëzues të hollësishëm sa i takon parimeve të hartimit të silabuseve, metodave të mësimdhënies, përzgjedhjes së literaturës, sistemit të kontrollit dhe vlerësimit të dijeve të studentëve, këshillimit akademik dhe tutoriatit, etj⁶². Gjithashtu UET organizon vazhdimisht trajnime të personelit akademik të fokusuara kryesisht në aspektet didaktike të mësimdhënies, duke nxitur përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimit, duke u mbështetur tek ndërveprimi i vazhdueshëm me studentët dhe gjithëpërfshirja e tyre në zhvillimin e procesit mësimor cilësisht.</p> <p>Gjatë vitit të fundit, në situatën e pandemisë Covid-19, këto trajnime kanë qënë të fokusuara kryesisht në zhvillimin e mësimdhënies online, metodave dhe teknologjive të përdorura.⁶³</p> <p>Monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë është ndjekur kryesisht nga Zyra e IT e cila ka hartuar raportet përkatëse⁶⁴ dhe raportimet nga Përgjegjësit e Departamentit.</p> <p>Në politikat e UET mekanizmat e përcaktuara të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i mësimdhënies në auditor, kryesisht për anëtarët e personelit akademik të kategorisë lektorë dhe asistentë lektorë, nga Dekani, Përgjegjësi i Departamentit ose përgjegjësit të grup-lëndës;⁶⁵ • Vlerësimi i pedagogut dhe lëndës nga studentët që kryhet në fund të çdo semestri, duke ruajtur anonimatit e tyre, vlerësimi përmes fokus grupeve me studentët, si dhe përmes opinionëve e mendimeve që ata shprehin në mbledhjet e hapura të departamentit;⁶⁶

⁶² Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës (Ref. Nr. 39); Rregullore e UET, Kreu V (Ref. Nr. 5); Platforma LMS (Ref. Nr. 46, 46.1, 46.2, 46.3)

⁶³ Video trajnime mbi systemin TEAMS/LMS (Ref. Nr. 46.4)

⁶⁴ Raport: ecuria e mësimin online (Ref. Nr. 46.5)

⁶⁵ G.III.4.1 Formular i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegju (Ref. Nr. 30.8)

⁶⁶ G.III.4.2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët (Ref. Nr. 40)

	<ul style="list-style-type: none"> • Vetvlerësimi;⁶⁷ • Rezultatet e raporteve të KSBC-së;⁶⁸ • Vlerësimi nga Komisioni i Vlerësimit të Performancës që ngrihet nga Rektori (follow-up). • Zhvillimi i leksioneve të hapura, për një nga temat e planifikuara.
<p>Kriteri 2. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit/eseja, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit⁶⁹ Diplomë Profesionale në Dizajn i Aplikuar dhe Modë, qartësisht janë shprehur format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive si: Leksione, Seminarët për çdo lëndë, Ese/Detyra e kursit, Praktika Profesionale, etj. Njëkohësisht në formë më të detajuar edhe në planin mësimor të programit paraqiten veprimtaritë formuese të tij⁷⁰.</p> <p>Leksionet dhe seminarët zgjasin për 14 javë (semestri)^{71, 72}, dhe në javën e 13 të semestrit studentët dorëzojnë detyrat e kursit/ esetë në lëndët e zhvilluara. Praktikë profesionale zhvillohet gjatë semestrit të dytë të vitit të dytë. Format e mësimdhënies dhe mësimnxënies qartësisht janë të përshtatshme për realizimin e programit të studimit.</p> <p>Kontrolli i dijeve është i vazhdueshëm, përgjatë gjithë semestrit, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të identifikojnë mangësitë dhe t'i plotësojnë ato përpara përfundimit të semestrit.⁷³ Gjithashtu, në bashkëpunim me tregun e punës, Departamenti ka zhvilluar leksione të hapura me ekspertë të fushës së Arteve.⁷⁴</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, në përgjigje dhe të</p>	<p>Format, mënyrat dhe metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies janë të specifikuara në syllabusin e lëndës^{75, 76, 77} i cili ndërtohet në përgjigje të nevojave të lëndës dhe studentëve, dhe përmban rubrika si: “Metoda pedagogjike e përdorur në seminarin e radhës”, “Literaturë bazë e detyrueshme”, “Literaturë e rekomanduar”, etj. Në zhvillimin</p>

⁶⁷ G.I.12.1 Formulari i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik (Ref. Nr. 41)

⁶⁸ Format_Raporti për provimet (Ref. Nr. 30.6); Shpërndarja e relacionit të KSBC mbi silabuset (Ref. Nr. 30.7); Format relacioni për vlerësimin e përputhshmërisë së silabuseve (Ref. Nr. 37)

⁶⁹ Rregullore mësimore e programit të studimit (Ref. nr. 7).

⁷⁰ Plani mësimor i Programit të studimit me karakter profesional në Dizajn i Aplikuar dhe Modë (Ref.Nr.14.1)

⁷¹ Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës (Ref. Nr. 5); Kalendar akademik (Ref. Nr. 10.1-10.3)

⁷² Rregullore mësimore e programit të studimit (Ref. nr. 7).

⁷³ ANEKS: Tabelat përmbledhëse – Tabela 15

⁷⁴ Takime_aktivitete Bordi i Tregut të Punës (Ref. Nr. 12. 4); Plani strategjik për zhvillimin e programit (Ref. Nr. 4); Analiza e departamentit përgjegjës (Ref. Nr. 38)

⁷⁵ A.III Mbi parimet e ndertimit te programit te lendes (Ref. Nr. 39).

⁷⁶ Silabuset e lëndëve (Ref. Nr. 19)

⁷⁷ VKM nr. 41, datë 24.01.2018’Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë’, i ndryshuar (Ref. nr. 53. 1)

diversitetit dhe nevojave të studentëve.	<p>e lëndëve në auditor përdoren gjerësisht edhe mjete ndihmëse si tabela, kompjuteri, projektori, etj. Metoda të tjera për t'iu përgjigjur diversitetit përfshijnë diskutime dhe punë në grupe me studentet, analiza e rasteve të studimit, organizimi i diskutimeve që nxisin mendimin kritik, etj.</p> <p>Prej gati 1 viti, për shkak të pandemisë, procesi akademik është duke u zhvilluar online, dhe mësimdhënia zhvillohet nëpërmjet përdorimit të dy platformave online UET-LMS, dhe TEAMS⁷⁸, të cilat kanë ndihmuar së tepërmi që procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies të kryhet sa më normalisht.</p>			
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në programin me karakter profesional në “Dizajn i Aplikuar dhe Modë”, përveç titujve dhe gradave kanë edhe background profesional me përvojë të gjatë në këtë fushë.⁷⁹ Personeli akademik gjatë leksioneve/seminare/praktikave përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, ku në varësi të tematikës përdor metodat tradicionale ose bashkëkohore të mësimdhënies. Këto metoda ndërthuren duke pasur herë në qendër studentin dhe herë pedagogun.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>UET organizon vazhdimisht trajnime të personelit akademik të fokusuar kryesisht në aspektet didaktike të mësimdhënies, duke nxitur përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimit. Gjithashtu trajnime zhvillohen edhe në kuadër të angazhimit në veprimtari kërkimore shkencore dhe të publikimeve në revista shkencore serioze. Në realizimin e këtij kriteri vjen në ndihmë edhe inkurajimi dhe mbështetja e stafit akademik për pjesëmarrjen në aktivitete zhvilluese, si brenda ashtu edhe jashtë vendit⁸⁰.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.2 Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe</p>	<p>Infrastruktura në dispozicion të zhvillimit të procesit</p>

⁷⁸ Vendim_Mbi zhvillimin e procesit akademik në situatën e krijuar nga pandemia (Ref. Nr. 5.1)

⁷⁹ CV e stafit (Ref. Nr. 20)

⁸⁰ Raporti analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit (seksioni për shkëmbimin e stafit) (Ref. Nr. 35)

<p>cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>mësimor plotëson standardet dhe kriteret e cilësisë. Godinat janë të pajisura me sistem kondicionimi dhe sistem interneti wireless. Të gjitha sallat në të cilat zhvillohen si leksionet ashtu edhe seminarët janë të pastra dhe të pajisura me PC, lidhje në internet dhe videoprojektor, të cilat i vijnë në ndihmë si studentëve ashtu edhe stafit akademik. Të gjithë laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin mjaft modern të procesit mësimor. Mirëmbajtja dhe azhurnimi i pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i Zyrës së Teknologjisë së Informacionit, instalimet e programeve dhe azhurnimet e tyre bëhen në kohë reale. Laboratorët e informatikës janë të pajisura me programet e nevojshme për lëndët e dizajnit grafik dhe produksionit audiovizual të përcaktuara në programin mësimor.⁸¹ Në ambientet e shkollës gjithashtu disponohet lidhja me rrjetin wireless në internet. Për studentët e Dizajn i Aplikuar dhe Modë, janë në dispozicion edhe 3 salla të cilat kanë ndriçim të mirë për të zhvilluar detyrat e vizatimit, pikturës, dhe të dizajnit, si dhe hapësirën e Tirana Design Academy për zhvillimin e punës mësimore në lëndët e dizajnit të modës.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Duke ndjekur zhvillimet e reja teknologjike, UET ka investuar në sisteme, të cilat e mbështesin studentin në procesin mësimor. Më konkretisht në sistemin MOODLE (UET LMS), i cili i mundëson studentit në kohë reale të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive etj.⁸² për periudhën e Pandemisë, përveç sistemit LMS, UET disponon te licencuar edhe aplikacionin Microsoft Teams, për zhvillimin e leksioneve online. Ambientet e shkollës mbulohen nga rrjeti Wireless, që i mundëson studentëve dhe personelit akademik akses në internet dhe në platformat e sipërpërmendura.</p>
<p>Kriteri 3. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Biblioteka e UET është e pasur dhe disponon literaturën e mjaftueshme që ndihmon studentin në përvetësimin e dijeve sipas programit dhe lëndëve mësimore përkatëse.⁸³ Biblioteka e UET furnizohet vazhdimisht me botime periodike. Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programeve.</p>

⁸¹ Infrastruktura në funksion të programeve të studimit (Ref. Nr. 42)

⁸² Manuali i përdorimit të UMIS (Ref. Nr. 46); Materialet mbi TEAMS/LMS (Ref. Nr. 46.1 – 46.4)

⁸³ Inventari i teksteve për fushën e programit të studimit (Ref. Nr. 45)

	<p>UET bën përpjekje të konsiderueshme për furnizimin me botime periodike dhe elektronike për t'i shërbyer pedagogëve dhe studentëve.⁸⁴ Biblioteka është abonuar për një periudhë 5-vjeçare në libraritë elektronike Sage & Ebsco si edhe Questia.⁸⁵ Në lidhje me programin e Arteve Pamore, pjesa më e madhe e literaturës, lidhet me lëndët e pikturës, dizjanit, multimedias apo historisë së artit. Biblioteka e shkollës përmban libra akademikë, literaturë referuese apo manuale që iu vijnë në ndihmë leksioneve për lëndët e sipërpërmendura.⁸⁶ Për sa i përket lëndëve të vizatimit dhe pikturës, mësimet zhvillohen nën drejtimin e pedagogëve, të cilët shpjegojnë, vëzhgojnë dhe drejtojnë studentët në zhvillimin e punimeve tyre, por duke respektuar unin dhe procesin artistik të studentëve, pra duke ndjekur kështu traditën e akademive të mëdha të artit. Megjithatë, biblioteka e shkollës iu mundëson studentëve akses në manualët e ndryshme të pikturës, vizatimit dhe anatomisë artistike si literaturë ku ata mund t'iu referohen për të eksploruar dhe zhvilluar artistikisht edhe në mënyrë individuale.</p>
<p>Kriteri 4. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Biblioteka mundëson aksesin në libraritë online si për personelin akademik, ashtu edhe për studentët. Stafi i bibliotekës ofron mbështetje gjetjen e burimeve online të kërkuara. Biblioteka është e pajisur me PC, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të lexojnë bibliotekat on-line të vëna në dispozicion nga UET.⁸⁷ Gjithashtu biblioteka ka siguruar akses në burime ndërkombëtare elektronike për artikuj dhe libra shkencorë si: Questia, Social Science Library, Sage.⁸⁸ Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online).</p>
<p>Kriteri 5. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>UET disponon infrastrukturën e nevojshme për realizimin e objektivave mësimore. Çdo sallë është e pajisur me PC dhe projektor të cilat shfrytëzohen nga studentët për realizimin e diplomave apo detyrave të kursit. Laboratorët e informatikës janë të pajisura me</p>

⁸⁴ Formular për pasurimin e fondit të librave ne biblioteke (Ref. Nr. 45.2); Shembull procedure blerje literature (Ref. Nr. 45.3)

⁸⁵ ANEKS: Tabelat permbledhese – Tabela 17

⁸⁶ Dokumenti E-IV. Mbi funksionimin e Bibliotekës (Ref. Nr. 45.1); Inventari i teksteve për fushën e programit të studimit (Ref. Nr. 45)

⁸⁷ Infrastruktura në funksion të programeve të studimit (seksioni për bibliotekën) (Ref. Nr. 42); Inventari i teksteve për fushën e programit të studimit (fq.1. seksioni për bibliotekën) (Ref. Nr. 45);

⁸⁸ ANEKS: Tabelat permbledhese – Tabela 17

	<p>programet e nevojshme të përcaktuara në programin mësimor. Studenti mund të punojë në Bibliotekë ose në sallën e internetit për detyrat e kursit apo punimin e diplomës që duhet të shkruajë. Gjithashtu specifikisht për Artet Pamore (fusha e programit të studimit Dizajn i aplikuar dhe Modë), tre sallat kanë hapësira të mjaftueshme me ndriçim të konsiderueshëm për zhvillimin e disa lëndeve specifike të Arteve Pamore (të cilat janë gjithashtu pjesë e programit të studimit me karakter profesional në Dizajn i Aplikuar dhe Modë).⁸⁹ Për këtë program studimi, UET ka në dispozicion edhe hapësirën laboratorike të Tirana Design Academy.</p>			
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik i UET përdor platformën online UET LMS si dhe platformën Microsoft Teams. Sipas Urdhrit administrativ për LMS, nr. 09, date 02/11/2017 “Mbi zbatimin e plotë në procesin mësimor administrativ të platformës UET LMS”⁹⁰, personeli akademik, në kuadër të digjitalizimit të procesit të mësimdhënies në UET dhe menaxhimin efektiv të tij, urdhërohet vendosja në efikasitet të plotë e platformës UET LMS me të gjitha funksionet e saj. Çdo pedagog në UET komunikon me studentët e tij nëpërmjet UET LMS, Microsoft Teams por edhe nëpërmjet e-mail-it zyrtar të shkollës. Nëpërmjet këtij sistemi pedagogu bën njoftime, ngarkon silabusin, prezantimet, leksionet, weblink-e me material shtesë, hedh pikët e çdo vlerësimi për studentët e tij, etj.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.3 Institucioni ngrre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe</p>	<p>Në UET është ngritur dhe funksionin KSBC (KSBC në UET)⁹¹, e cila ngrihet në nivel institucional.</p>

⁸⁹ Infrastruktura në funksion të programeve të studimit (Ref. Nr. 42);

⁹⁰ Urdher Mbi zbatimin e platformës LMS (Ref. nr. 46.1)

⁹¹ Dokumenti F.VII Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë” (Ref. Nr. 8).

<p>monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.</p>	<p>Antarët⁹² e saj propozohen nga Rektori dhe miratohen nga Senati i Universitetit.</p> <p>Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është një strukturë autonome, e përhershme në strukturën organizative të universitetit. Ai vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, si dhe propozon ndryshime për përmirësime të nevojshme, mbështetur në udhëzimet e sigurimit të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë dhe legjislacionit në fuqi⁹³. Kjo zyrë bashkëpunon me njësitë kryesore dhe bazë dhe realizon një sërë aktivitetesh të parashikuara në planin e saj të veprimit⁹⁴, në funksion të monitorimit dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Qëllimet e kësaj njësie në funksion të koordinimit dhe bashkërendimit me njësitë kryesore bazë në kuadër të përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie sipas pikës F.VII.3, në rregulloren e KSBC përfshijnë: Rritja e vazhdueshme e cilësisë së drejtimit të UET-it, nëpërmjet krijimit dhe zbatimit të politikave, strategjive dhe procedurave bashkëkohore, si edhe angazhimit të të gjitha niveleve drejtuese dhe organizative; aplikimi i vazhdueshëm i filozofisë së UET-it, duke zbatuar një program akademik që përkon si nga ana konceptuale dhe kronologjike me synimet që ka UET-i; rritja e vazhdueshme e cilësisë së formimit të studentëve, duke u ofruar atyre dijet, metodat dhe teknikat më bashkëkohore të mësimdhënies dhe duke nxitur përfshirjen e tyre në vendimarrje⁹⁵.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies në programet e studimit që ai ofron. Ai përzgjedh personelin akademik që angazhohet në mësimdhënie, si edhe garanton shpërndarjen e ngarkesës mësimore në përputhje me parimet dhe kriteret e vendosura për të garantuar që mësimi të zhvillohet nga personeli me ekspertizën dhe kualifikimin e nevojshëm. Gjithashtu përgjegjësi i departamentit miraton silabuset e hartuara, bën vlerësimin e mësimdhënies, qoftë duke ndjekur zhvillimin e orëve të mësimimit nga personeli akademik,</p>

⁹² Të dhëna për anëtarët e KSBC (Ref. Nr. 30); Urdhër administrative mbi përbërjen e KSBC (Ref. Nr. 30.4)

⁹³ Statuti i Universitetit Europian të Tiranës (Ref. Nr. 2)

⁹⁴ Plani i veprimit të KSBC (Ref. Nr. 30.1)

⁹⁵ Dokumenti F.VII Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (Ref. Nr. 8).

	<p>qoftë duke inkurajuar studentët të raportojnë për problemet që mund të jenë evidentuar, në mbledhjet e hapura me ta, por jo vetëm.⁹⁶ Stafi dhe studentët e dinë që do i nënshtrohen një procesi të vlerësimit të mësimdhënies, gjë e cila rrit vetdijen për cilësinë e mësimdhënies.⁹⁷</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale.</p>	<p>Personeli akademik i UET ka mundësi të përmirësojë aftësitë e tij në mësimdhënie, duke shfrytëzuar edhe përdorimin e metodave të reja, përmes:</p> <ol style="list-style-type: none"> Periudhave të shkëmbimit të eksperiencës në universitete partere, në kuadër të programeve Erasmus+ KA1. Trajnimeve të herëpashershme nga lektorë të ftuar, apo anëtarë të personelit të UET (zyra e IT, apo njësi të tjera). <p>Personeli akademik nëpërmjet literaturës që përzgjedh, temave që përdor, shembujve me të cilët i ilustron, formave të mësimdhënies që përdor, të cilat pasqyrohen në syllabusin e lëndës, dhe që përmirësohen në çdo semester, kontribuon në mënyrë të drejtperdrejtë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.⁹⁸ Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik është pjesë e trajnimeve të vazhdueshme. Gjithashtu, Sekretaria Mësimore⁹⁹ mban evidencat për zhvillimin e orëve të mësimin, leksione/seminare. Ajo raporton në fund të çdo jave, për orët e pazhvilluara te Sekretari i Përgjithshëm, te Dekanët e Fakulteteve dhe te Zyra e Burimeve Njerëzore. Dekani dhe Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me Sekretarinë Mësimore monitorojnë zhvillimin e procesit mësimor në përputhje me orarin i cili ishte i shpallur. Përmirësimi i mësimdhënies dhe implementimi i metodave të reja mundësohet edhe nëpërmjet zhvillimit të leksioneve të hapura; vlerësimit nga studentët; vlerësimit të Dekanit dhe/ose Përgjegjësit të Departamentit; vlerësimit nga Komisioni i Vlerësimit të Performancës që ngrihet nga Rektori, në fund të çdo viti akademik (follow-up), etj.</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit</p>	<p>Personelit akademik i kërkohet të shfrytëzojë maksimalisht metodat e reja inovative në procesin e mësimdhënies. Në formatin që përdoret për hartimin e</p>

⁹⁶ Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit (Ref. Nr. 6)

⁹⁷ Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët (Ref. Nr. 40)

⁹⁸ Syllabuset e lendeve (Ref. Nr. 19)

⁹⁹ E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore (Ref. Nr. 9)

<p>akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të tyre.</p>	<p>silabuseve, personelit akademik i kërkohet të evidentojnë në një seksion të veçantë të syllabusit për çdo temë “Metodat pedagogjike që do të përdoren”.¹⁰⁰</p>			
<p>Kriteri 5. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Personeli akademik ka lirinë të testojë metoda të reja në mësimdhënie, dhe duke qenë se silabuset e lëndëve rishikohen çdo vit, ka mundësi të reflektojë përshtatjet dhe ndryshimet e nevojshme, në përputhje me rezultatet e përdorimit të tyre në përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies tek studentët. Nëse gjatë punës së tyre ata vënë re se një eksperiencë e re është efektive, raportojnë për rezultatet në mbledhjen e departamentit, me synim që kjo eksperiencë pozitive të përhapet dhe shfrytëzohet edhe nga kolegët e tjerë. Por dhe në trajnimet e ndryshme të personelit akademik, stafi është i lirë të sugjerojë metoda që kanë rezultuar pozitive dhe të diskutojnë rreth tyre, me qëllim përhapjen e praktikave më të mira.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.4 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimmimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregulloren e programit të studimit, pika 5 “Kontrolli dhe vlerësimi i dijeve”, si edhe me dokument të veçantë¹⁰¹, rregullator të UET. Për lëndët e Tipologjisë I, studentët zhvillojnë dy detyra praktike gjatë semestrit secila me 30% të notes përfundimtare dhe 40% të saj studentët e fitojnë përmes provimit final të sezonit. Për lëndët e Tipologjisë II, vlerësimi për notën përfundimtare mbështetet në këto komponentë: 10%, aktivizimi gjatë procesit mësimor, 20%, detyra e kursit, 30%, provim i ndërmjetëm dhe 40%, provimi final i sezonit. Edhe në kushtet e mësimdhënies online për shkak të situatës së krijuar</p>

¹⁰⁰ Syllabuset e lendeve (Ref. Nr. 19)

¹⁰¹ Sistemi i vlerësimit të studenteve (Ref. Nr. 7.1)

	nga pandemia Covid-19, vlerësimi dhe kontrolli i dijeve mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, sipas kriterëve të përcaktuar në rregulloren e organizmit të mësimdhënies. ¹⁰² Kriteret dhe mënyra e testimit të njohurive u njoftohen studentëve gjatë javës së orientimit (për studentët e rinj), por edhe nga secili pedagog në auditor për lëndët përkatëse. Gjithashtu, studenti mund të përfitojë nga shërbimi i kujdesit dhe këshillimit të vazhdueshëm që ofrohet nga Koordinatorja e departamentit dhe Zyra e Kujdesit ndaj Studentit. ¹⁰³
<p>Kriteri 2. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe ka qëllim të trefishtë.</p> <ol style="list-style-type: none"> Nxit studentin që të mësojë gjatë gjithë vitit; Prodhon një vlerësim më objektiv të studentit, duke e ndarë notën në disa komponentë në krahasim me vlerësimin e bazuar vetëm në një provim; Shërben për të vlerësuar ecurinë e kursit gjatë semestrit, nëse studentët janë duke e kuptuar materialin që po ofrohet në kurs. <p>Në rregullore parashikohen forma të ndryshme të kontrollit të dijeve dhe aftësive, me qëllim që pedagogu të mund të zgjedhë atë që i përshtatet më mirë natyrës së lëndës dhe evidenton më mirë rezultatet e synuara të të nxënit.¹⁰⁴</p>
<p>Kriteri 3. Në fillim të çdo lënde/moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës /modulit.</p>	<p>Në fillim të çdo semestri studentët njihen me silabusin e lëndës, në të cilin përcaktohen në mënyrë të detajuar mënyra e kontrollit dhe format e vlerësimit të dijeve, së bashku me afatet kur duhet të plotësohet secili detyrim deri në përfundim të zhvillimit të lëndës.¹⁰⁵ Njoftime të detajuara për detyrat dhe provimet në kuadër të lëndës vendosen edhe në platformën LMS, si dhe u njoftohen me email nga koordinatoreja e departamentit.</p>
<p>Kriteri 4. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat</p>	<p>Provimet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare zhvillohen brenda afatit të caktuar në Kalendarin e Vitit Akademik.¹⁰⁶ Si rregull, provimet e ndërmjetme</p>

¹⁰² Vendim mbi zhvillimin e procesit akademik ne situaten e krijuar nga pandemia Covid-19 (Ref. Nr. 5.1); Rregullore tranzitore mbi vijimin e procesit akademik gjatë semestrit të pare te vitit akademik 2020-2021 në kushtet e pandemise Covid-19 (Ref. Nr. 5.2); Rregullore tranzitore per zhvillimin e procesit akademik gjate vitit akademik 2020-2021 (Ref. Nr. 5.3)

¹⁰³ Mbi funksionimin e Zyres se Keshillimit te Karrieres dhe Kujdesit ndaj Studentit (Ref. Nr. 12)

¹⁰⁴ Sistemi i vleresimit te studenteve (Ref. Nr. 7.1); Rregullore e programit te studimit (Ref. Nr. 7)

¹⁰⁵ Format i silabusit (Ref. Nr. 19.1); Silabuset e lendeve (Ref. Nr. 19)

¹⁰⁶ Kalendar i akademik (Ref. Nr. 10.1; 10.2; 10.3)

<p>garantojnë anonimatën, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>zhvillohen në javën e 7-të të semestrit me kohëzgjatje normale, ndërsa provimet përfundimtare në fund të semestrit¹⁰⁷. Shpërndarja e komponentëve të vlerësimit¹⁰⁸ është në formën: provim përfundimtar, provim të ndërmjetëm, detyrë kursi, niveli i diskutimit në seminar apo detyrat praktike¹⁰⁹. Provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korigjuara në Sekretarinë Mësimore. Sekretimi i tezave përmes sistemit elektronik të barkodeve, ofron sekretim të identitetit të studentit dhe paanshmëri të vlerësimit. Prej rreth 1 viti , për shkak të pandemisë, pjesa më e madhe e provimeve është zhvilluar online, provimet e ndërmjetme janë hequr, dhe realizimi i të gjitha rubrikave të vlerësimit të provimit , është bërë në formë elektronike.</p> <p>Provimet në formë elektronike zhvillohen në platformën UET LMS dhe në platformën Microsoft Teams, ku studentët dorëzojnë detyrat qoftë për punimet individuale, po ashtu për punimet e realizuara në grup, si dhe bëjnë provimet në kohë reale. Gjatë provimit, ata kontrollohen në kohë reale nga pedagogu i lëndës përgjatë seancës së provimit.</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisione provimi, shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi të gjithë komponentëve të parashikuar tek detyrimet akademike që studenti duhet të përmbushë, kërkohet të shoqërohet me argumentet përkatëse nga ana e pedagogut, me qëllim që studentit të jetë i qartë mbi mangësitë apo gabimet në përgjigjet që ka dhënë, për të pasur mundësi t'i përmirësojë në testimet e radhës. Në funksion të sqarimit të studentit janë edhe seancat sqaruese, ku ata mund të shohin në detaje korigjimin e pedagogut dhe të marrin drejtpërdrejtë nga ai/a jo komente të detajuara mbi vlerësimin e tyre.¹¹⁰</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore.</p>	<p>Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale mbështeten mbi meritën, ku pedagogu falë sekretimit të tezave nuk është në dijeni mbi identitetin e studentit dhe jepen në kohën e parashikuar sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre. Studentët kanë të drejtën e ankimit dhe rivlerësimit, proces i cili zhvillohet gjatë seancave sqaruese, të cilat janë</p>

¹⁰⁷ Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës “Provimet” (Ref. Nr. 5)

¹⁰⁸ Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës neni.17 “Planifikimi i procesit mesimor” (Ref. Nr. 5)

¹⁰⁹ Kalendari akademik (Ref. Nr.10.1, 10.2, 10.3)

¹¹⁰ Rregullorja e programit të studimit, Neni 5.3. Provimet (Ref. Nr. 7)

	<p>të detyrueshme për çdo lëndë. Seanca sqaruese ju vjen në ndihmë studentëve duke siguruar feedback mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. Studentët kanë të drejtë të bëjnë kërkesë për rishikimin e vlerësimit të provimit, në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Pas zhvillimit të provimit në rast se ndeshet kërkesë apo ankimim, ajo do të shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm, i cili përbëhet nga tre anëtarë, në përbërjen e të cilit nuk është pedagogu i lëndës. Komisioni vendos nëse vlerësimi ka qënë korrekt ose jo, dhe ndërmerr veprimet e nevojshme sipas rastit, duke dhënë rezultatin përfundimtar. Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (provim i ndërmjetëm, detyrë kursi/detyra praktike, provim përfundimtar), pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës ai mund t'i drejtojë Përgjegjësit të Departamentit një kërkesë me shkrim, ku të parashtrijë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Me marrjen e ankesës, Përgjegjësi i Departamentit ose Dekani, kur pedagogu i lëndës është vetë Përgjegjësi i Departamentit, ngre një Komision për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Vendimi i Komisionit, i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar. Procedura e ndjekur pasi i është dhënë zgjidhje respektivisht do të dokumentohet dhe arkivohet ¹¹¹.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Standardi III.5 Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme.</p>	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përfitimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, që janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxënit për programet me karakter profesional.</p>	<p>Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përfitimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale në përputhje me rezultatet e të nxënit, të cilat janë:</p> <p>a. Njohuri dhe koncepte bazë të fushës së studimit;</p>

¹¹¹ Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës, Neni 32 “Kerkesa per rivlerësim” (Ref. Nr. 5)

	<p>b. Aftësi drejt një profesioni apo licence profesionale;</p> <p>c. Formim qytetar të përgjithshëm;</p> <p>d. Aftësi bazë për punë kërkimore aplikative;</p> <p>e. Aftësi të përgjithshme praktike, aplikative;</p> <p>f. Aftësim për promovim personal;</p> <p>g. Projekt profesional pa origjinalitet kërkimor por që dëshmon aftësitë e tij brenda profesionit të zgjedhur¹¹².</p> <p>Rubrikat e programit të studimit janë të plotësuara me lëndë, të cilat ndihmojnë në zhvillimin e aftësimin profesional të studentit, në përmbushje të objektivave të programit të studimit, sikurse citohen në rregulloren e tij.</p> <p>Programi i studimit është i hartuar në mënyrë të tillë që i përshtatet përgatitjes së specialistëve të fushës sipas nivelit të 5 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Kohëzgjatja e tij dhe forma e studimit bazohet në legjislacionin Shqiptar dhe është e përshtatshme për këtë program studimi. Pothuajse të gjithë lëndët që zhvillohen në këtë program studimi janë konceptuar me 6 kredite ndërsa:</p> <p>Programi zgjat 2 (dy) vite/4 (katër) semestra.</p> <p>Në total 120 kredite në dy vite akademike, 60 Kredite/vit.</p> <p>19 lëndë/pa module + Praktikë dhe zhvillim studentit + Provim formimi (PPP)/Projekt profesional.</p> <p>19 provime/lëndë + praktika + diploma (Provimi formimi (PPP) /Projekt profesional).</p> <p>Ngarkesa totale në auditor është: Viti I 575 orë, Viti II 593 orë, Gjithsej 1168 orë mësimore në auditor.</p> <p>Format e mësimdhënies në planin mësimor (Plani mësimor për Programin e studimit me karakter profesional në “Dizajn i Aplikuar dhe Mode”)¹¹³ janë: Leksione, Seminare, Praktikë profesionale, Punim i Diplomës (Provimi formimi/Projekt profesional).</p> <p>Jepen kreditet korresponduese për çdo lëndë, për praktikën dhe për diplomën (Provimi formimi/Projekt profesional).</p>
--	--

¹¹² Rregullore mesimore e programit të studimit, Pika 3.3 Objektivat e Programit të studimit (Ref. Nr. 7)

¹¹³ Plani mësimor i programit të studimit (Ref. Nr. 14.1)

	<p>Organizimi i lëndëve/moduleve bashkë me veprimtaritë e tjera formuese dhe punimin e diplomës është bërë në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p> <p>Strukturimi i lëndëve/moduleve është i përshtatshëm për realizimin e objektivave formuese të programit.</p> <p>Plani mësimor është i qartë dhe në të janë të paraqitura lëndët/modulet me gjithë ngarkesën e tyre.</p> <p>Në planin mësimor ngarkesa mësimore është e përcaktura qartë po ashtu edhe forma e mësimdhënies për çdo lëndë.</p> <p>Shpërndarja e lëndëve është e përshtatshme dhe e krahasueshme me programe të ngjashme brënda dhe jashtë vëndit.</p> <p>Lëndët janë të organizuara në dy tipologji. Për lëndët e Tipologjisë I, programi parashikon këto forma vlerësimi: a. Provimit përfundimtar (40%), b. Detyrave praktike: $2 \text{ (dy)} \times 30\% = (60\%)$. Për lëndët e Tipologjisë II, programi parashikon këto forma vlerësimi: a. Provimit përfundimtar (40%), b. Provimit të ndërmjetëm (30%), c. Detyrë kursi 1 (20%), d. Nivelit të diskutimit në seminare (10%).</p> <p>Praktika profesionale e studentëve organizohet, ndiqet dhe mbikëqyret nga Drejtuesi i Departamentit në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës. Si veprimtari formuese e programit, ajo është e detyrueshme dhe kusht i domosdoshëm për të përfunduar studimet. Studenti i cili nuk shlyen praktikën profesionale nuk ka të drejtë të mbrojë diplomën.¹¹⁴</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.</p>	<p>Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara, duke i përgatitur studentët me njohuri bazë aplikative në këtë fushë si dhe nëndisiplinat përkatëse, si edhe duke synuar formimin e specialistëve me kompetenca të zgjeruara praktike.¹¹⁵</p>
<p>Kriteri 3. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale, duke garantuar realizimin</p>	<p>Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Në syllabusin</p>

¹¹⁴ Rregullore e programit të studimit, Pika 7. Praktika profesionale (Ref. Nr. 7); Mbi praktikën profesionale (Ref. Nr. 32.1)

¹¹⁵ Plani mësimor i programit (Ref. Nr. 14.1)

<p>në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>e çdo lënde përcaktohen “përmbledhja dhe qëllimit e kursit”, të cilat në përgjithësi janë konform objektivave të programit të studimit. Më tej temat e specifikuar të lëndës kontribuojnë tërësisht në këtë drejtim. Në këtë mënyrë, studentët marrin njohuri teoriko-praktike të nivelit profesional dhe praktik, që kërkohen nga fusha e dizajnit dhe modës, si edhe aftësi dhe kompetenca, të kërkuara nga tregu i punës.</p> <p>Eksperienca që personeli akademik merr gjatë mobiliteteve në institucionet/universitete partnere, realizimit të projekteve shkencore, si dhe bashkëpunimeve me institucione të tjera akademike, reflektohen në përmirësimin e formave të mësimdhënies. Gjatë shkëmbimit të eksperiencave promovohen universitetet dhe vendet, për të rritur shanset dhe motivimin e studentëve për një eksperiencë jashtë institucionit të tyre¹¹⁶.</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon e shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Si rregull, pedagogët përpara përfundimit të lëndës bëjnë një përmbledhje të koncepteve dhe çështjeve kryesore të zhvilluara, duke përfshirë në diskutim edhe studentët dhe duke marrë mendimin e tyre për çfarë mund të përmirësohet në vijim. Eseja, apo detyra e kursit që zhvillohet përpara përfundimit të lëndës është një formë e shqyrtimit të aftësisë së studentëve për të kuptuar çfarë ata kanë përfituar nga lënda. Në rastin e Arteve Pamore (fushe e studimeve të programit DP Dizajn i Aplikuar dhe Mode), duke qënë edhe një program specifik i cili e ka qëllimin në aplikimin praktik të shprehive artistike, studentët zhvillojnë provimet e tyre në sallë, duke prezantuar punimet e tyre së bashku me kolegët e tyre.</p> <p>Në orën e fundit të mësimit, pedagogu përveçse ndalet edhe njëherë në çështjet më të rëndësishme të trajtuara gjatë semestrit, jep edhe orientimet e nevojshme se ku duhet të fokusohen studentët për përgatitjen e tyre në provim. Pedagogu mund të ndalet më gjatë në elementët që kanë rezultuar më të vështirë për t’u përvetësuar nga studentët, gjatë semestrit. Gjithashtu pedagogu është në dispozicion të studentëve për konsulta përpara provimit edhe gjatë orëve të takimit zyrtar, sipas grafikut të shpallur në fillim të semestrit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e</p>	<p>Institucioni ka hartuar procedura të posaçme për</p>

¹¹⁶ Analiza e departamentit përgjegjes (Ref. Nr. 38); Raporti analitik i perfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit (Ref. Nr. 35)

<p>studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.</p>	<p>diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen në procesin e diplomimit. Rregullorja e Diplomimit,¹¹⁷ Rregullorja e programit të studimit, përmbajnë të gjithë elementet e kërkuara nga ky kriter. Të dhënat e studentëve të diplomuar mbahen në regjistrat zyrtarë të institucionit.</p>			
<p>Kriteri 6. Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke garantuar bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj.</p>	<p>Diplomimi bëhet me përgatitjen dhe mbrojtjen e një projekti profesional me karakter aplikativ/praktik për një temë të caktuar praktike aplikative ose nëpërmjet Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar (ndryshe: Provim formimi) (PPP)¹¹⁸ që zhvillohet në formën e rastit studimor, të lidhur ngushtë me lëndët karakterizuese të programit (Kategoria B). Në çdo rast, studenti nuk mund të zhvillojë PPP, pa shlyer të gjitha detyrimet e tjera të programit të studimit¹¹⁹. Përpara zhvillimit të PPP, pedagogë të ndryshëm orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e tij.</p> <p>Në kuadër të realizimit të objektivave e procesit mësimor të programit DP “Dizajn i Aplikuar dhe Modë”, institucioni ka bashkëpunuar dhe ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë dhe institucione vendase, ku realizimi i praktikave profesionale mbetet një ndër komponentët kryesor, së bashku me krijimin e lidhjeve midis universitetit dhe aktorëve të tregut të punës, në funksion të punësimit të studentëve, por edhe për të qenë më pranë nevojave të tregut të punës dhe reflektimit të tyre në programin e studimit¹²⁰.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

¹¹⁷ Rregullore mesimore e programit të studimit (seksioni për Diplomimin) (Ref. Nr. 7).

¹¹⁸ Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës (Ref. Nr. 39).

¹¹⁹ Rregullore mesimore e programit të studimit (Ref. Nr. 7).

¹²⁰ Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit (Ref. Nr. 32); ANEKS: Tabelat përmbledhese – Tabelat 5.1, 5.2, 5.3

IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efikente dhe efektive nga ana e tyre	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.</p>	<p>Universiteti European i Tiranës i ka të përcaktuara në dokumentacionin bazë që rregullon veprimtarinë e institucionit, parimet, kriteret dhe procedurat për punësimin e personelit akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme¹²¹, ¹²². Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs. UET- ja ka një kuadër rregullativ të brendshëm mbi të cilin mbështetet procesi i punësimit të personelit akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme. Politikat dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik shpjegohen qartë, qëllimi, kriteret, raste të veçanta për rekrutimin e personelit akademik që bëhet në përputhje me nevojat për pedagogë, bazuar në planet mësimore që zhvillohen në kuadrin e çdo Fakulteti/Departamenti, si dhe ngarkesat mësimore të miratuara. Personeli i angazhuar në programet e studimit me karakter profesional realizon ngarkesën¹²³ mësimore sipas akteve në fuqi dhe kontratës së lidhur me UET. Në vitin akademik 2020-2021, në programin e studimit angazhohen: 1 Prof. As.; 4 Dr.; 10 MSc., personel akademik me përvojë në fushën e arteve dhe kompetent për lëndët që mbulojnë në program.¹²⁴</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarë në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe</p>	<p>Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Në fund të çdo viti akademik pedagogu i brendshëm plotëson dhe dorëzon në Zyrën e Burimeve Njerezore aneksin për realizimin e ngarkesës vjetore. Bazuar në pikën G.II.4.1, dokumentit të Burimeve Njerezore, Përgjegjësi i Departamentit përgjigjet për respektimin e parimeve të shpërndarjes së ngarkesës dhe raporton për këtë shpërndarje tek Zyra e Burimeve Njerezore në fillim të çdo semestri.¹²⁵</p>

¹²¹ Statuti i Universitetit European të Tiranës, Neni 44 (Ref. Nr. 2)

¹²² Dokumenti për Burimet Njerezore (Ref. Nr. 11); Shembull thirrje staf akademik (Ref. Nr. 11.1)

¹²³ Ngarkesa mesimore në auditor e stafit akademik të programit (Ref. Nr. 25)

¹²⁴ Ngarkesa mesimore në auditor e stafit akademik të programit (Ref. Nr. 25); ANEKS: Tabelat përmbledhese – Tabelat 12; CV e stafit akademik (Ref. Nr. 20)

¹²⁵ Rregullore për Burimet Njerezore (Ref. Nr. 11)

administrativ të angazhuar.	Çdo vit i gjithë stafi i përfshirë në programin e studimit raporton në lidhje me përditësimet e CV-së së vet, ¹²⁶ publikimet dhe konferencat shkencore, realizimin e ngarkesës mësimore për secilin simester, projektet shkencore të realizuara, aktivitetet shkencore të pritshme, të ftuarit në auditor, etj. ¹²⁷ Këto të dhëna i raportohen fillimisht (Përgjegjësit të Departamentit) departamentit, përpara se të depozitohen në Zyrën e Burimeve Njerëzore.
<p>Kriteri 3. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Personeli akademik është i angazhuar për përmbushjen e objektivave të programit të studimit, dhe këtë Institucioni e dëshmon nëpërmjet kontrolleve dhe vlerësimeve për personelin akademik. Departamenti përgjegjës për programin e studimit, nëpërmjet kordinatorës së tij ndjek ecurinë e veprimtarive formuese në përmbushje të objektivave të programit, që nga realizimi i orëve mësimore, ese-ve dhe detyrave të kursit, Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar, etj. Këto evidenca dërgohen tek zyrat përkatëse në nivel institucional. Gjithashtu Departamenti (dhe Institucioni) vlerëson në mënyrë periodike të gjithë aktivitetin mësimdhënës të stafit akademik nëpërmjet, vlerësimeve të pedagogëve nga studentët¹²⁸, vlerësimit të pedagogëve prej eprorit/kolegut¹²⁹, mbledhjeve të hapura me studentët, si edhe vlerësimit të përgjithshëm disa vjeçar që kryhet në nivel institucional. Gjithashtu, departamenti mbështet stafin akademik për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive. Institucioni ka mundur një mjedis të përshtatshëm i cili lehtëson dhe mundëson kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. Ky mjedis është i garantuar në terma të infrastrukturës fizike dhe asaj teknologjike. Mjediset për Fakultetin/përgjegjës për programin e studimit janë të shumta, si: Salla për leksione; Klasa për seminare; Salla për veprimtari promovuese; Salla për praktikë profesionale; Laboratorë informatike; Salla për bibliotekë etj. Të gjitha sallat mësimore (leksione dhe seminare) janë të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektore. Sistemi i kondicionimit ndodhet në çdo ambient në UET¹³⁰.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që</p>	<p>Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon</p>

¹²⁶ Format dosje staf akademik me kohe të plote (Ref. Nr. 44.1); Format dosje staf akademik me kohe të pjesshme (Ref. Nr. 44.2)

¹²⁷ Raportim i punës krijuese artistike dhe kerkimore shkencore DAA 2018-2021 (Ref. Nr. 43.2)

¹²⁸ Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët (Ref. Nr. 40)

¹²⁹ Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu (Ref. Nr. 30.8)

¹³⁰ Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit (Ref. Nr. 42)

<p>mbulon dhe administron programin e studimit, përmes organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>dhe administron programin e studimit. Kështu UET here pas here organizon trajnime për stafin akademik, ku në mënyrë të veçantë gjatë simestrit të dytë të vitit të shkuar dhe simestrit të parë të vitit aktual janë organizuar trajnime online ne lidhje mësimdhënien në përshtatje me kushtet e pandemisë COVID-19. Në këto trajnime janë dhënë informacione për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja si: përdorimi i platformës TEAMS (për mësimdhënien) dhe LMS (për të gjitha aktivitetet e tjera formuese)¹³¹. Ndër këto trajnime përmendim: trajnimi me temë “Trajnimi i stafit për platformën Teams” në kuadër të zhvillimit të mësimin online për shkak të situatës së krijuar nga pandemia prej virusit SARS CoV-2; trajnimi UET¹³² LMS¹³³ për stafin akademik etj.</p> <p>Institucioni, Fakulteti dhe Departamenti gjithashtu mbështetin stafin akademik për kualifikimin e mëtejshëm profesional. UET mbulon shpenzimet për pjesëmarrjen në konferenca dhe trajnime në vend dhe jashtë vendit, nëpërmjet granteve, gjithashtu ekziston një nxitje dhe motivim institucional për bashkëpunim me institucionet homologe në rajon dhe jashtë vendit. Institucioni nxit publikimin e artikujve, pjesëmarrjen në konferenca, projekte, mobilitete jashtë vendit, etj. Institucioni gjithashtu vendos në dispozicion të publikimeve revistat institucionale dhe Konferencën Ndërkombëtare “Ditët e Studimeve Shqiptare”.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në</p>	<p>Duke iu referuar dokumentit 42 në listen e dokumentave për infrastrukturën, tek Godina B për Fakultetin e Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, ka një sipërfaqe</p>

¹³¹ Mbi zhvillimin e procesit akademik ne situaten e krijuar nga pandemia COVID-19 (Ref. Nr. 5.1).

¹³² Video-trajnime mbi sistemin TEAMS/LMS (Ref. Nr. 46.4)

¹³³ UET-LMS Guidë për pedagogun (Ref. Nr. 46.2)

<p>përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>rreth 500 m² ku strehohen laboratorët:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Laboratori i Arteve Pamore dhe Dizajnit – me një sipërfaqe rreth 250m² • Laboratori i Arteve Skenike dhe Muzikore – me një sipërfaqe rreth 250m² • Laboratori i Tirana Design Academy <p>Laboratori i informatikës përdoret nga studentët e Arteve Pamore (fushë e programit të studimit “Dizajn i Aplikuar dhe Mode) edhe për të mësuar format e reja teknologjike për dizajnin, produksionin audiovizual/multimedial dhe grafikën digjitale, konkretisht të mësojnë të krijojnë projekte të ndryshme të shtypit, multimedias apo forma të ndryshme të grafikës dhe dizajnit digjital në PC.</p> <p>Në Godinën A, për Departamentin e Arteve ka njëkohësisht edhe një laborator audioviziv i cili përdoret për Artet Muzikore, dhe Artet Skenike (Aula Magna), si dhe gjithashtu Holli i kësaj godine shërben njëkohësisht si një ambient ku studentët zhvillojnë ekspozita dhe aktivitete të ndryshme për të prezantuar punimet e tyre dhe përdoret për Artet Pamore në zhvillimin e procesit mësimor. Sipërfaqja totale e godinave të Universitetit është rreth 11,500 m². Në këtë shifër nuk përfshihet sipërfaqja përreth godinave.</p> <p>Sipërfaqet e shfrytëzueshme janë të ndara në salla leksionesh, gjithsej 10 salla me sipërfaqe totale 1510m² dhe 1515 vende. Salla seminari janë gjithsej 14, me sipërfaqe 45m² dhe secila me nga 35 karrige. Salla 70 vendesh (leksione + seminare) janë gjithsej 9 salla me sipërfaqe 100m² secila.</p> <p>Numri i studentëve të programit të studimit Diplomë Profesionale në “Dizajn i Aplikuar dhe Mode”, është brenda standardit të kërkuar. Konkretisht, numri i studentëve që kanë ndjekur gjatë 2018-2021 programin e studimit Diplomë Profesionale në “Dizajn i Aplikuar dhe Mode”, në total është 44¹³⁴. Duke qënë se numri i studentëve nuk është shumë i madh, mundësohet një përkushtim mjaft i madh i institucionit ndaj studentëve të programit.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive</p>	<p>Mjediset për Fakultetin/përgjegjës për programin e studimit janë të shumta, si: Salla për leksione; Klasa për seminare; Salla për veprimtari promovuese; Salla për praktikë lëndore/profesionale; Laboratorë informatike; Salla për bibliotekë; Innolab; Zyrë informacioni për studentët;</p>

¹³⁴ Cilesia ne hyrje dhe ne dalje e studenteve (Ref. Nr. 27)

<p>bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Mjedise për aktivitetet e Qeverisë Studentore; dhe hapësira të tjera. Të gjitha sallat mësimore (leksione dhe seminare) janë të pajisura me mjete audio vizive si kompjutera e projektore. Sistemi i kondicionimit ndodhet në çdo ambient në UET. Pajisjet dhe infrastruktura në dispozicion vlerësohen të përshtatshme dhe në përputhje me qëllimet dhe nevojat e zhvillimit bashkëkohor të mësimdhënies dhe mësimnxënies¹³⁵. Ambientet universitare janë të mbuluara nga rrjeti Wi-Fi në internet në mënyrë që studentët të kenë akses në web.</p> <p>Prej rreth një viti procesi akademik është duke u zhvilluar online dhe për mbarëvajtjen e procesit UET ka vendosur në dispozicion të pedagogëve dhe studentëve platformat mësimore UET-LMS dhe Teams¹³⁶.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Programet kompjuterike iu janë përshtatur programeve mësimore duke instaluar programet aplikative që kërkohen nga departamentet përkatëse mësimore. Për programin e studimit “Diplomë Profesionale” në “Dizajn i Aplikuar dhe Modë”, është vënë në dispozicion laborator i Arteve Pamore dhe Dizajnit me një sipërfaqe rreth 250 m², ndërsa për programet e studimit të Arteve Skenike dhe Muzikore janë vënë në dispozicion laborator i Arteve Skenike me një sipërfaqe rreth 250 m² dhe salla Aula Magna me një sipërfaqe rreth 200 m² dhe kapacitet akomodues prej 125 persona, e cila është konceptuar në formë teatri. Ambjenti është i pajisur me një post i konceptuar për regjinë dhe produksionin audio e video. Holli i Godinës A, gjithashtu shërben njëkohësisht si një ambient ku studentët zhvillojnë ekspozita dhe aktivitete të ndryshme për të prezantuar punimet e tyre dhe përdorët për Artet Pamore në zhvillimin e procesit mësimor.¹³⁷</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.</p>	<p>Programet e studimit me karakter profesional dhe programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë lëndën Bazat e Informatikës, për të cilën universiteti ka vënë në dispozicion 4 laboratorët e Informatikës. Në dispozicion të lëndëve të lidhura me inovacionin, është vënë Laboratori “Innovation Hub”, i cili ndodhet në sallën 208, në katin e dytë të godinës A. Ky laborator ka një kapacitet prej 24 PC.</p> <p>4 Laboratorë Informatike, përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lab 205 B me 25 PC dhe video projektor rreth 45 m2; - Lab 206 B me 35 PC dhe video projektor rreth 45 m2;

¹³⁵ Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit (Ref. Nr. 42)

¹³⁶ Mbi zhvillimin e procesit mesimor ne kushtet e situates se krijuar nga pamdemia COVID-19 (Ref. Nr. 5.1)

¹³⁷ Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit (Ref. Nr. 42)

	- Lab 207 B me 35 PC dhe video projektor rreth 45 m ² ; - Lab 208 B me 80 PC (laboratori i internetit) – 160m ² . ¹³⁸			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike thelbësore për programet me karakter profesional.	Praktika profesionale është detyrim akademik që synon të lidhë njohuritë teorike dhe praktike të fituara gjatë studimeve me profesionin/et përkatës/e dhe t'i familjarizojë studentët me tregun e punës. UET ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe organizata të ndryshme, ku parashikohet edhe bashkëpunimi në funksion të kryerjes së praktikave profesionale të studentëve. ¹³⁹ Gjithashtu edhe panairi i tregut të punës që organizohet nga institucioni në bashkëpunim me kompani të ndryshme bëhet edhe për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. ¹⁴⁰			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse e të posaçme të mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijon kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Bibloteka që institucioni vë në dispozicion të studentëve është godina C me një sipërfaqe gjithsej 300 m ² . Orari i Bibliotekës është përshtatur sipas programeve të studimit që fillon: nga e Hëne-Premte 9:00-20:00 e Shtunë 9:00:17:00. Kurse gjatë sezonit të provimeve është me orar të zgjatur. Ajo është e aksesueshme nga të gjithë studentët e programit të studimit. Qëllimi i bibliotekës është t'i shërbejë procesit mësimor dhe kërkimor në përputhje me programet e studimit që ofrohen në UET. Biblioteka është e aksesueshme nga të gjithë studentët e UET në mënyrë të barabartë e pa pagesë. Biblioteka ka gjithsej 150 vende leximi, 12 kompjutera, dhe gjithë ambjenti është i mbuluar nga rrjeti Wireless ne menyre qe studentet te kene mundesi te lexojne bibiliotekat online tevena ne dispozicion te studenteve. ¹⁴¹

¹³⁸ Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit (Ref. Nr. 42)

¹³⁹ Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkepunuese (Ref. Nr. 32); ANEKS: Tabelat permbledhese – Tabelat 5.1, 5.2, 5.3; Marreveshje bashkepunimi (Ref. Nr. 34.1 – 34.12)

¹⁴⁰ Poster Panairi i punes 2018 dhe 2019 (Ref. Nr. 12.2); Realitetet e reja Post-Covid 19 ne Tregun e punes (Ref. Nr. 12.3)

¹⁴¹ Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit (Ref. Nr. 42); ANEKS: Tabelat permbledhese – Tabela 17

	<p>Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online). COBISS.Net është një rrjet ku janë të përfshira të gjitha vendet e rajonit të Europës Juglindore, e cila përfaqëson një model organizativ të lidhjes së bibliotekave në sistemin kombëtar të informacionit bibliotekar me katalogim të përbashkët, me bazën bibliografike (katalogun) të përbashkët të të dhënave dhe me bazat lokale të bibliotekave pjesëmarrëse.</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>UET siguron tekste mësimore cilësore, që përcaktohen në silabuset e çdo lënde. Biblioteka në total disponon libra Bruto, Periodik, CD & Harta 6425 tituj. Libra ne gjuhen shqipe 4931 tituj. Libra ne gjuhe te huaj 1666 tituj. Periodik total 170 tituj. Periodik shqip 105 tituj. Periodik ne gjuhe te huaj (anglisht, frengjisht, italisht) perafersisht 67 tituj. Gjithashtu për Fakultetin e Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale disponon 1861 tituj. CD & Harta 85 Biblioteka funksionon me orar të gjatë dhe ofron kushte të mira dhe një fond të pasur botimesh hard copy dhe elektronike, në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaja, për të mbështetur studentët dhe personelin akademik në punën e tyre studimore dhe kërkimore shkencore. Të dhëna të detajuara gjenden në dokumentin Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit^{142, 143}.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>UET disponon bibliotekën, ku, pasurimi i fondit të saj¹⁴⁴ bëhet përmes: blerjeve¹⁴⁵ në fillim të çdo fillim viti akademik i një numri të konsiderueshëm tekstesh universitare dhe librash të reja që janë pjesë e lëndëve përkatëse të kurrikulave¹⁴⁶ shkollore si tekstet bazë ose si literaturë e rekomanduar; blerjeve në Panairin Kombëtar të Librit në nëntor të çdo viti të botimeve më të rëndësishme që lidhen drejtpërsëdrejti apo tërthorazi me procesin mësimor, përkthimi dhe botimi nga UET Press i shumë teksteve, që kanë për autorë pedagogë të UET, studiues të tjerë shqiptarë dhe autorë të huaj, klasikë dhe bashkëkohorë; si dhe koleksionet e plota të të gjitha revistave shkencore që botohen nga UET; porosive dhe blerjeve online në Amazon.com e dhjetra apo qindra botimeve të rëndësishme</p>

¹⁴² Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit (Ref. Nr. 42)

¹⁴³ ANEKS: Tabelat permbledhese – Tabela 17; Inventari I teksteve per fushen e programit (Ref. Nr. 45)

¹⁴⁴ Formular për pasurimin e fondit të librave në bibliotekë (Ref. Nr. 45.2)

¹⁴⁵ Shembull procedurë blerje literature (Ref. Nr. 45.3)

¹⁴⁶ E.VIII Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave (Ref. Nr. 13)

	<p>dhe nga më të fundit në gjuhën angleze në ato fusha të shkencës me të cilat identifikohet me së miri ekspertiza e UET.</p> <p>Gjithashtu UET ka kryer disa abonime në biblioteka virtuale, dhe revista shkencore në hard copy, të cilat ofrojnë për studentët dhe stafin akademik shumë tituj librash dhe artikuj shkencorë bashkëkohorë, ku mund të përmenden: Sage, Ebsco (abonim 5-vjeçar), Questia. Gjithashtu UET ka akses edhe në dy platforma të tjera elektronike falë ndihmës së Shoqatës së Bibliotekave, EIFL (Electronic Information for Libraries) si : ASTM Compass dhe Edward Elgar Publishing – Elgar online platform¹⁴⁷.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t’u lehtësojnë dhe garantojë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve.</p>	<p>UET ka lidhur marrëveshje me shumë institucione, biznese apo aktorë të tjerë të arsimit të lartë, kulturës dhe tregut të punës në përgjithësi. Entitete të ndryshme kanë kontribuar në forma nga më të shumta për të përmirësuar procesin mësimor të programit. Për shembull, shtëpitë botuese kanë dhuruar libra për të pasuruar fondin e bibliotekës së UET, në benefit të studentëve jo vetëm të programit me karakter profesional “Dizajn i Aplikuar dhe Modës”, por për të gjithë studentët e UET.</p> <p>Gjithashtu nëpërmjet bashkëpunimit dhe punës së realizuar nga Zyra e Projekteve dhe Partneriteteve, universiteti siguron jo vetëm financime dhe pjesëmarrje në projekte kërkimore por edhe bashkëpunime me agjenci të jashtëme (në mënyrë të veçantë me institucionet e huaja) dhe biznese që i vijnë në ndihmë të programeve mësimore dhe studentëve direkt.</p> <p>Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm (të brendshëm dhe të huaj), të angazhuar në realizimin e programit mësimor¹⁴⁸, u lehtëson dhe garanton studentëve mbështetje dhe përdorimin e burimeve dhe logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni parashikon koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi.</p>	<p>Buxhetimi financiar hartohet në muajin nëntor-dhjetor të çdo viti dhe miratohet. Për zbatim të këtij buxhetimi, ngarkohet Administratori dhe Zyra e Financës. Projekt buxheti hartohet në mënyrë të tillë ku përcaktohet çdo muaj një raport i drejtë i të ardhurave dhe shpenzimeve duke përcaktuar dhe rezervat e nevojshme për shpenzimet që kanë prioritet në vazhdimësi. Plani i financimit hartohet në nivel institucional, ku përfshihen të gjithë kostot dhe të ardhurat. Për shkak të përmasave të institucionit por edhe faktit që infrastruktura por edhe stafi angazhohet në</p>

¹⁴⁷ ANEKS: Tabelat permbledhese – Tabela 17; Inventari I teksteve per fushen e programit (Ref. Nr. 45)

¹⁴⁸ Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese. (Ref. Nr. 32)

	programe të ndryshme është praktikisht e pamundur të hartohen raporte në bazë të programeve të studimit. Të gjitha këto janë të pasqyruara në raportin financiar të përvitshëm të institucionit. ¹⁴⁹			
Kriteri 6. Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim.	Të dhënat financiare dëshmojnë aftësinë e institucionit për të garantuar qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit, sikurse dhe dëshmon kapacitete për gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen ¹⁵⁰ .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe i jep formacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kriteret të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Institucioni harton dhe zbaton politika specifike gjatë gjithë ciklit të studimit duke patur parasysh terrenin dhe evoluimin e përgjithshëm ndërkombëtar në këtë drejtim, të cilat përshtaten me nevojat dhe hapësirat e duhura, duke ruajtur parametrat optimalë, në një degë studimi me natyrë praktike. Politikat dhe procedurat mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore të cilat gjenden të detajuara në dokumentet e institucionit. Përmes këtyre dokumenteve, studentët sqarohen për procesin e pranimit dhe kriteret që duhet të plotesohen për pranim në programet e studimit dy- vjecare, strukturën e studimit, programin e lëndëve, kreditet e nevojshme për t'u diplomuar, mënyrën e vlerësimit, procesin e diplomimit dhe gjithçka tjetër që studentit mund t'i duhet gjatë studimeve të tij ¹⁵¹ . Institucioni trajton të gjithë studentët në mënyre të barabartë dhe demokratike gjatë gjithë ciklit të studimit, duke ruajtur dhe siguruar pritshmëritë e synuara për cilindo prej tyre, me

¹⁴⁹ ANEKS: Tabelat permbledhese – Tabela 18.1, 18.2

¹⁵⁰ ANEKS: Tabelat permbledhese – Tabela 18.1, 18.2

¹⁵¹ Rregullore e programit te studimit (Ref. Nr. 7)

	<p>qëllim që të përballojnë me sukses në të ardhmen terrenin dhe mundësitë dhe kërkesat që ofron tregu i punës.¹⁵²</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të përgjithshme dhe/ose të veçanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me to.</p>	<p>Me qëllim për të nxitur vendimarrjen e gjithë secilit në menyrë të pavaruar si edhe për të plotësuar interesat dhe aspiratat profesionale të gjithëkujt, institucioni harton dhe publikon çdo vit akademit kriteret dhe vendet vakante për degën tonë, duke informuar studentët potencial për natyrën praktike të degës.</p> <p>Faqja zyrtare e Universitetit European të Tiranës www.uet.edu.al; https://uet.edu.al/new/fakulteti-i-shkencave-humane-edukimit-dhe-arteve-liberale/?lang=sq</p> <p>Përpara fillimit të çdo viti akademik në faqen e internetit të universitetit¹⁵³, në faqen e facebook-ut, në njoftimet që bëhen në UET, në “Gjimnaz Tour-et”, studentët njoftohen në kohë për mënyrën e aplikimit dhe dokumentet e nevojshme. Programi i studimit pranon kandidatët në varësi të kapaciteteve infrastrukturore dhe akademike të UET-it dhe sipas kritereve specifike që mund të përcaktohen paraprakisht nga Dekanati. Numri i maksimal i studentëve që mund të regjistrohen dhe mënyrat e përzgjedhjes së tyre, bëhen publike çdo fillim viti akademik, para fillimit të regjistrimeve. Në fillim të vitit akademik organizohet java orientuese, ku mbahen takime dhe leksione për shpjegimin e sistemit të studimeve, të rregulloreve dhe të procedurave administrative në UET për studentët e rinj.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit.</p>	<p>Institucioni e njeh si detyrim dhe angazhim të vendosë në dispozicion për studentët dhe të gjithë të interesuarit, informacionin e plotë dhe të hollësishëm mbi kalimin nga një vit në tjetrin, si p.sh numri minimal i krediteve për të kaluar nga një vit në tjetrin është 30 dhe ai maksimal 60. Informacioni i plotë nevojshëm për përparimin e studentit në rrugëtimin e tij përgjatë programit (që nga ora e parë mesilore e deri në prezantimin e diplomës), është shpalosur në mënyrë të hollësishme dhe shteruese në rregulloren e programit me karakter profesional “Dizajn i Aplikuar dhe Modë”. Lëndët që do të zhvillohen përgjatë programit janë të parashtruara në Kurrikulën e programit.</p>
<p>Kriteri 4. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni ofron përgjatë gjithë vitit kalendarik informacion për çdo student në mënyrë të detajuar për strukturën e degës, kohëzgjatjen e programit, për lëndët që kanë në programin e tyre dhe organizimin se si ato ndahen ndër vite në bazë të tipologjive.</p> <p>Universiteti angazhon burime njerëzore në informimin e</p>

¹⁵² Rregullore e UET, Neni 42 (Ref. Nr. 5)

¹⁵³ Të dhëna nga Faqja zyrtare e Web (<https://uet.edu.al/new/si-te-aplikojme/?lang=sq>)

	<p>hollësishëm para dhe gjatë procesit të regjistrimit, nëpërmjet Zyrës së Pranimeve, si dhe nëpërmjet shpërndarjes së materialeve informuese si broshura e fletëpalosje. Gjithashtu një mënyrë tjetër informimi për studentët e ardhshëm është nëpërmjet “Gjimnaz Tour-eve” që universiteti realizon. Këto tour-e kanë si qëllim dhënien e informacioneve specifike për mundësitë e studimit në programet që UET ofron, duke u kujdesur që kandidatët potencialë të kenë kuptuar qartësisht dhe të vlerësojnë mundësinë individuale për tu bërë pjesë e programeve. Duke qenë se këto tour-e realizohen gjatë semestrit të dytë të vitit akademik, koha e vënë në dispozicion për aplikim është e mjaftueshme për t’u kuptuar mirë procesin dhe për të përgatitur një aplikim të mirë. Në fillim të çdo viti akademik organizohet në UET java orientuese, ku mbahen takime dhe leksione për shpjegimin e sistemit të studimeve, të rregulloreve, të procedurave administrative dhe zhvillimit të procesit mësimor në UET, për të gjithë studentët përfshirë dhe ata të rinj.</p> <p>Ne mbështetje të studenteve për orientimin në tregun e punës janë Zyra e Keshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studenteve dhe takimet dhe aktivitetet e zhvilluara me Bordin e Tregut të Punës, aktiviteti i Panairit të Punës, etj.¹⁵⁴.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Institucioni në informacionin e përgjithshëm që vendos në dispozicion për audiencën universitare, përfshin çdo të dhënë të mundshme dhe detaje specifike për lëndët përkatëse dhe e përcjellatë me anë të çdo mjeti komunikimi qoftë në zyrat përkatëse, me e-mail, në sistemin LMS, apo dhe nga vetë pedagogu përkatës i lëndeve.</p> <p>Informacioni i detajuar në lidhje me lëndët (sipas kategorise përkatëse: A-Lëndë Bazë, B-Lëndë karakterizuese, C-Lëndë të Formimit Profesional , D- Lëndë plotësuese dhe E-Detyrime përmbyllëse) gjendet në Web-faqjen e Universitetit¹⁵⁵. Sekretaria, koordinatore të programit dhe pedagogët përmes kryerjes së funksioneve të tyre, janë përgjegjës për administrimin e informacionit, dokumentacionit dhe aktivitetin mësimor të studentëve duke e vendosur atë në dispozicion të studentëve. Një procedurë tjetër e rëndësishme informative për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit</p>

¹⁵⁴ Mbi funksionimin e Zyres së Keshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit (Ref. Nr. 12); Poster Panairi i Punës (Ref. Nr. 12.2); Takime aktivitetesh Bordi i Tregut të Punës (Ref. Nr. 12.4)

¹⁵⁵ Të dhëna nga faqja zyrtare e web (<https://uet.edu.al/new/wp-content/uploads/2019/01/DP-Dizajn-i-aplikuar-dhe-Mode.pdf>)

	mësimor, jepet edhe gjatë javës së përzgjedhjes së lëndëve përpara çdo semestri, si prej këshilluesve të karrierës dhe prej regjistruarëve të lëndëve.			
Kriteri 6. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	UET në kuadër të dixhitalizimit të procesit të mësimdhënies, ka ndërtuar Sistemin e Menaxhimit të Mësimdhënies UET LMS. UET LMS është një platformë në rrjet, e bazuar tek Moodle, e cila u krijon akses studentëve tek materialet e lëndëve që vendosen online nga pedagogu, si edhe për të përdorur disa mjete të ndryshme me synim përmirësimin e mësimdhënies. ¹⁵⁶ Të gjithë anëtarët e personelit akademik, efektiv dhe me kohë të pjesshme, të cilët zhvillojnë mësim u jepet akses vetëm tek lënda/lëndët e tyre, dhe tek grupet përkatëse me të cilët zhvillojnë mësim. Çdo pedagog mund të shohë vetëm lëndët e veta dhe të menaxhojë krejt lehtësisht gjithë literaturën e lëndëve përkatëse; Sistemi ofron mundësi për çdo lloj kërkese që pedagogu mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies, si p.sh. caktimi detyrave të kursit, të gjitha llojet e vlerësimit për çdo tipologji, pyetësorë të ndryshëm, evente, forum diskutimi online mes studentëve dhe pedagogut, dhe shumë funksione të tjera. Të gjitha këto sigurojnë një informim të mirë të studentëve në lidhje me ecurinë e studimit dhe janë lehtësisht të aksesueshme në çdo moment nga studentët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.	Sistemi i menaxhimit nëpërmjet të cilit institucioni administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit është UMIS. Është një program informatik i cili është krijuar për të realizuar ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave personale të studentit, rekordeve akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit, si: programet e studimit,

¹⁵⁶ Manuali I përdorimit të sistemit UMIS (Ref. Nr. 46); UET LMS Guide për studentët (Ref. Nr. 46.3); Video-trajnime mbi sistemin TEAMS/LMS (Ref. Nr. 46.4)

	<p>orarin mësimor, fondin e librave të Bibliotekës, etj. Sistemi i Menaxhimit të Studentit, i cili përmban informacionin personal të studentit, regjistrimin e lëndëve dhe rezultatet e provimeve/detyrave, regjistrimin në programet e studimit dhe lëndët përkatëse për çdo vit akademik, deri në diplomim; Sistemi i Menaxhimit të Programeve të Studimit dhe Lëndëve, i cili bën të mundur hartimin e programeve të studimit, duke përcaktuar kategoritë, kreditet dhe kushtet e regjistrimit të lëndëve, si dhe detyrimet që duhet të përmbushë studenti për të përfunduar me sukses programin e studimit.¹⁵⁷</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Një nga elementët e tjera të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Universitetit (UMIS) është edhe “Portali i pedagogëve”, që përmban informacion mbi projektet kërkimore; ndihmon pedagogët në hedhjen e notave në sistem, njoftime të nevojshme etj. (referuar pika E.V., Mbi politikat e prezantimit/promovimit të UET on – line, Broshura e dokumenteve në zbatim të statutit dhe të rregullores bazë të UET-IT). Gjithashtu, edhe nëpërmjet sistemit MOODLE (UET LMS), i cili bën të mundur që studenti në kohë reale të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive etj. Ka mundësi të komunikojë nëpërmjet sistemit në forume të hapura me pedagogët si dhe kolegët e kursit që ndjek; të shikojë notat dhe pikët on-line nga kudo që ndodhet. Për të nxitur përdorimin e kësaj platforme ka shërbyer edhe Udhri Administrativ nr.9 datë 02.11.2017 për zbatimin e plotë të saj.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>UET në kuadër të dixhitalizimit të procesit të mësimdhënies, ka ndërtuar Sistemin e Menaxhimit të Mësimdhënies UET LMS. UET LMS është një platformë në rrjet, e bazuar tek Moodle, e cila u krijon akses studentëve tek materialet e lëndëve që vendosen online nga pedagogu, si edhe për të përdorur disa mjete të ndryshme me synim përmirësimin e mësimdhënies. Të gjithë anëtarët e personelit akademik, efektiv dhe me kohë të pjesshme, të cilët zhvillojnë mësim u jepet akses vetëm tek lënda/lëndët e tyre, dhe tek grupet përkatëse me të cilët zhvillojnë mësim. Çdo pedagog mund të shohë vetëm lëndët e veta dhe të menaxhojë krejt lehtësisht gjithë literaturën e lëndëve përkatëse; Sistemi ofron mundësi për çdo lloj kërkese që pedagogu mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies, si p.sh. caktimi detyrave të kursit, të gjitha llojet e vlerësimit për çdo tipologji, pyetësorë të ndryshëm,</p>

¹⁵⁷ ANEKS: Tabelat përmbledhese – Tabela 17 (seksioni për strukturën e teknologjisë së informacionit që menaxhon IAL); Manuali i përdorimit të sistemit UMIS (Ref. Nr. 46)

	<p>evente, forum diskutimi online mes studentëve dhe pedagogut, dhe shumë funksione të tjera. Sistemi UET-LMS lidhet kryesisht me procesin mesimor, dhe duke qënë se prej një viti aktiviteti akademik po zhvillohet online për shkak të Pandemisë, në UET po përdoret edhe sistemi Microsoft Teams që lidhet vecanërisht me mësimdhënien online.</p> <p>Gjithashtu, në çdo zyrë të stafit akademik dhe administrativ, në kompjuterat përkatës gjendet databaza e Institucionit me emërtimin “Dokumenta UET”, ku secili anëtar i institucionit mund të aksesojë në kohë reale të dhëna lidhur me strategjitë, rregulloret, urdhërat administrativ, standartet, dhe çdo informacion dhe dokumentacion tjetër lidhur me aktivitetin e personelit akademik, ndihmës-akademik dhe partnerët e angazhuar në realizimin e programit.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>UET LMS është një program kompjuterik që përdoret për administrimin, dokumentimin, ndjekjen, raportimin dhe shpërndarjen elektronike të materialeve të ndryshme që përdoren për zhvillimin e lëndëve, pjesë e programeve të studimit në UET. Platforma u krijon mundësi pedagogëve dhe studentëve të ndërveprojnë përmes internetit si të ishin në auditor. Ky sistem ofron informacion të personalizuar për çdo përdorues student apo pedagog. Çdo student, apo pedagog që hyn në sistem, merr vetëm informacionin që i përket atij.</p> <p>Krahas përdorimit të platformës së posaçme UET LMS, personeli akademik dhe studentët mund të komunikojmë virtualisht dhe Microsoft Teams, dhe gjithashtu edhe nëpërmjet email-it. Në secilin rast, studentëve u vihet në dispozicion çdo lloj materiali lidhur me lëndët që ata zhvillojnë, dhe çdo informacion lidhur me përmbushjen e detyrimeve të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Në kuadër të analizës së cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimit ndaj studentëve, në UET analizohet aktivizimi i çdo pedagogu në platformën interaktive UET LMS dhe Microsoft Teams, për lëndët dhe grupet e veta. Personi përgjegjës (Zyra e IT e UET) për menaxhimin e platformës UET LMS dhe Teams, dërgon në fund të çdo semestri, Raportin mbi aktivitetin e pedagogut në platformat interaktive, duke mundësuar raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.¹⁵⁸</p> <p>Platforma LMS (Learning Management System) është edhe një mjet eficient në dispozicion të Zyrës së Sigurimit të Cilësisë, për të monitoruar mbarëvajtjen e procesit të</p>

¹⁵⁸ Raport: ecuria e mesimit online (Ref. Nr. 46.5)

	akademik, përmes të dhënave statistikore të gjeneruara nga ky sistem.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Në faqen web të UET pasqyrohen informacione lidhur me të gjitha programet e studimit të ofruara nga institucioni, informacion lidhur me personelin akademik sipas fakulteteve dhe departamenteve përkatëse (kualifikimi dhe CV bio e personelit akademik) ¹⁵⁹ dhe çdo aktivitet në kuadër të veprimtarisë kërkimore shkencore, leksioneve të hapura si dhe leksioneve nga të ftuar të shquar të botës së biznesit dhe akademisë. Të gjitha këto informacione publikohen në faqen web të institucionit në dy gjuhë, në gjuhën shqipe dhe atë angleze.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

¹⁵⁹ Të dhëna nga faqja zyrtare e WEB Informacione për stafin dhe CV bio e stafit akademik të programit të studimit <https://uet.edu.al/new/fakulteti-i-shkencave-humane-edukimit-dhe-arteve-liberale/>

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kriteret të pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Në statutin dhe rregulloren e UET ¹⁶⁰ qartësisht tregohet baza ligjore mbi të cilën operon institucioni. Informacioni lidhur me kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, ¹⁶¹ të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit është lehtësisht i kuptueshëm dhe i aksesueshëm nga publiku nëpërmjet informacioneve të vendosura në website-n e institucionit ¹⁶² , kontaktit me zyrën e pranimit dhe me pedagogët e këshillimit të karrierës ¹⁶³ . Institucioni ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura të mirëpërcaktuara që nga pranimi dhe deri në përfundim të studimeve në ciklin e parë të studimit Diplomë Profesionale. Për këtë mbështetet në legjislacionin në fuqi dhe aktet rregullatore të tij ¹⁶⁴ .
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Institucioni trajton të gjithë studentët në mënyre të barabartë dhe demokratike gjatë gjithë ciklit të studimit, duke ruajtur dhe siguruar pritshmëritë e synuara për cilindo prej tyre, me qëllim që të përballojnë me sukses në të ardhmen terrenin dhe mundësitë dhe kërkesat që ofron tregu i punës. ^{165, 166} Shancet e barabarta për të gjithë studentet garantojnë ofrimin e mundësive të njëjta për t'u përfshirë në aktivitete dhe takime që organizon departamenti. ¹⁶⁷
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe, përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Përpara çdo viti akademik institucioni harton dhe publikon kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programet e studimit me karakter profesional në përgjithësi dhe në DP Dizajn i Aplikuar dhe Modë në veçanti, të cilat janë në përputhje me ndryshimet e mundshme në legjislacionin përkatës. ¹⁶⁸ Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e

¹⁶⁰ Statuti i Universitetit Europian të Tiranës (Ref. Nr. 2)

¹⁶¹ Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin (Ref. Nr. 28)

¹⁶² Të dhëna nga faqja zyrtare e WEB <https://uet.edu.al/new/aplikimet-dhe-pranimet/?lang=sq>

¹⁶³ Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës (Ref. Nr. 5)

¹⁶⁴ Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës (Ref. Nr. 5); Rregullore mesimore e programit të studimit (Ref. Nr. 7)

¹⁶⁵ Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës, Neni 11 (Ref. Nr. 5).

¹⁶⁶ Rregullore mesimore e programit të studimit (Ref. Nr. 7)

¹⁶⁷ Analiza e departamentit përgjegjës (Ref. Nr. 38); Aktivitetet dhe veprimtaritë artistike të stafit akademik dhe përfshirja e studentëve (Ref. Nr. 43)

¹⁶⁸ Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve (Ref. Nr. 27.1)

	<p>përgjithshme e të veçanta të programit të studimit nëpërmjet informacionit në website-n e tij, pritjes dhe informimit nga këshilluesit e karrierës, komunikimit me zyrën e pranimeve, takimeve me studentët potencialë (gjimnaz tour) etj.</p> <p>Ne aktet rregullatore të UET, janë shprehur format me të cilat mund të realizohet udhëzimi i studentëve të ardhshëm:</p> <ol style="list-style-type: none"> Organizim i takimeve informuese, sqaruese dhe ndërgjegjësuere me gjimnazistë të gjimnazeve të Tiranës, të qyteteve të tjera të vendit dhe të Rajonit në mjediset e tyre; Organizimi i seminareve, i tryezave të rrumbullakëta, i leksioneve hyrëse dhe i veprimtarive të tjera me karakter mësimor-informues-argëtues me gjimnazistë të gjimnazeve të Tiranës, të qyteteve të tjera të vendit dhe të Rajonit në mjediset e UET-it; Përgatitje e materialeve informuese, sqaruese, ndërgjegjësuere si për shembull fletëpalosje, postera, broshura etj., dhe të atyre vizive si: spote televizive, mesazhe promovionale etj; Zyra e Pranimeve mban evidencat e personave të interesuar për të ndjekur studimet në UET. <p>Organizim logjistik, orientues, me mbështetje brenda burimeve njerëzore të UET-it për “Javët e Regjistrimit”, gjatë të cilave të interesuarit informohen, sqarohen, këshillohen mbi sistemin e studimeve, procedurat e aplikimit dhe të pranimit dhe gjithashtu pajisen me dokumentacionin përkatës.¹⁶⁹</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme.</p>	<p>Nëpërmjet zyrës së pranimeve, zyrës së këshillimit të karrierës dhe sekretarisë, kordinatorëve të departamenteve, regjistruerëve të lëndëve dhe platformave elektronike (UET-LMS & UMIS) institucioni vë në dispozicion dhe ofron informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe shtyrjes së studimeve në një vit tjetër akademik, të pershkruara në aktet rregullatore të tij.¹⁷⁰</p> <p>Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, udhëzimeve përkatëse të MAS-it dhe në përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës, Universiteti European i Tiranës pranon transferime të studentëve në vitet ndërmjetëse nga shkollat e tjera të larta,</p>

¹⁶⁹ Politika e marketingut të programit të studimit (Ref. Nr. 51); Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET (Ref. Nr. 48)

¹⁷⁰ Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve (Ref. Nr. 27.1); Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin (Ref. Nr. 28)

	<p>vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të tij në shkolla të tjera të larta, sipas procedurave të parashikuara në këtë dokument. Studenti i cili dëshiron të transferojë studimet në UET, informohet për të gjitha procedurat, kriteret që ndiqen në rastin e transferimit të studimeve (këto procedura janë të shprehura në Rregulloren Mësimore të UET, Rregulloren Mësimore të Programit të Studimit dhe dokumena të vecanta rregullore të UET). Në rast të transferimit të studimeve, në çdo rast studentit duhet të ndjekë në UET së paku një vit akademik. Studenti duhet të fitojë përmes programit të UET jo më pak se 25% të ECTS-ve në kategoritë e lëndëve A-D, si dhe të përmbushë detyrimet përmbyllëse (Kategoria E) të programit të studimit.</p> <p>Studenti informohet vazhdimisht dhe mbi përparimin e tij akademik, përmes sistemit UET-LMS, organizmin e tutriatit dhe keshillimit akademik. Në silabus të çdo lende janë të percaktuara format e kontrollit dhe vlerësimit të vazhdeshem.¹⁷¹</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit¹⁷² dhe Silabusi¹⁷³ i secilës lëndë, përmban informacion të detajuar lidhur me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit Diplomë Profesionale në “Dizajn i Aplikuar dhe Mode”. Studentët e aksesojnë informacionin nëpërmjet silabus-ëve, në mënyrë direkte në UET LMS dhe në çdo moment pranë zyrës së sekretarisë ose koordinatoreve të programit të studimit. Në fillim të çdo semestri, silabusi dhe kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve u shpjegohen atyre dhe diskutohen nga pedagogu.¹⁷⁴</p> <p>Institucioni ofron informacionin e duhur për studentët në lidhje me kriteret e procedurat e përgatitjes së Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar (PPP) apo Projektit aplikativ (diplomimit) në programin e studimit. Kjo gjë bëhet gjatë keshillimit në fillim të vitit akademik, dhe më pas në semestrin e dytë, përmes seancat orientuese ku pedagogët japin informacion në lidhje me mënyrën e zhvillimit të detyrimeve përmbyllëse në programin e studimit.</p>
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike,</p>	<p>Përgjatë javëve të regjistrimit, UET vë në dispozicion të maturantëve të interesuar për të vazhduar studimet e larta,</p>

¹⁷¹ Sistemi i vlerësimit të studentëve (Ref. Nr. 7.1); Rregullore e programit të studimit (Ref. Nr. 7); Mbi tutriatin dhe keshillimin akademik (Ref. Nr. 27.2); Silabusët e lendeve (Ref. Nr. 19)

¹⁷² Rregullore mësimore e programit të studimit (Ref. Nr. 7)

¹⁷³ Mbi parimet e ndertimit të programit të lendeve (Ref. Nr. 39).

¹⁷⁴ Mbi tutriatin dhe keshillimin akademik (Ref. Nr. 27.2); Silabusët e lendeve (Ref. Nr. 19)

<p>institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>grupe pedagogësh, sipas fakulteteve, të cilët japin të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me organizimin e programit të studimeve, kohëzgjatjen e tyre, rregulloren e universitetit, mundësitë e punësimit, mundësitë e transferimit të studimeve në UET ose nga UET në institucione të tjera brenda ose jashtëvendit.</p> <p>Institucioni çdo fillim viti zhvillon takime informuese të hapura për të diskutuar të gjitha zhvillimet e reja të degës tonë, duke krijuar atmosferën e duhur për t'i dhënë protagonizëm në përmirësimin dhe plotësimin e këtij procesi cilido prej studentëve duke e bërë në këtë pjesë aktive të hartimit dhe vënies në zbatim të tij.¹⁷⁵</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional.</p>	<p>Institucioni ofron përgjatë gjithë vitit kalendarik informacion për çdo student në mënyrë të detajuar për strukturën e kurrikules, kohëzgjatjen e programit, për lëndët që kanë në programin e tyre dhe organizimin se si ato ndahen ndër vite në bazë të tipologjive.</p> <p>Institucioni në informacionin e përgjithshëm që vendos në dispozicion për audiencën universitare¹⁷⁶, përfshin çdo të dhënë të mundshme dhe detaje specifike për lëndët përkatëse dhe e përcjellatë me anë të çdo mjeti komunikimi qoftë në zyrat përkatëse, me e-mail, në sistemin LMS, apo dhe nga vetë pedagogu përkatës i lëndeve.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Karrierës dhe kujdesit ndaj studenteve¹⁷⁷ është në shërbim të studentëve duke ofruar informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit, duke ofruar njëkohësisht asistencë për kryerjen e aplikimeve apo këshillimin e nevojshëm. Kjo zyrë ka krijuar kontakte të shumta me kompani private dhe institucione shtetërore dhe bashkëpunon ngushtë jo vetëm në</p>

¹⁷⁵ Politika e marketingut të programit të studimit (Ref. Nr. 51); Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET (Ref. Nr. 48)

¹⁷⁶ Faqja zyrtare web: <https://uet.edu.al/new/wp-content/uploads/2019/01/DP-Dizajn-i-aplikuar-dhe-Mode.pdf>

¹⁷⁷ Mbi funksionimin e zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit (Ref. Nr. 12)

	<p>funksion të zhvillimit të praktikave profesionale të studentëve pranë këtyre institucioneve, por edhe në kuadër të punësimit të ardhshëm të studentëve në këto kompani e organizata.</p> <p>Departamenti përgjegjës për programin e studimit, cakton një pedagog përgjegjës për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e praktikës profesionale. Ky pedagog në bashkëpunim edhe me Zyrën e Këshillimit të Karrierës informon dhe mbikqyr studentët dhe realizon kërkesat e praktikës profesionale, sikurse janë të specifikuara në silabusin e praktikës.¹⁷⁸</p>			
<p>Kriteri 3. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentët kanë informacionin e duhur mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Informohen nga zyrat përkatëse të kujdesit ndaj studentëve, sekretaria dhe kordinatorët përkatëse por edhe online nëpërmjet platformave UET LMS dhe Microsoft Teams. Gjithashtu një rol të rëndësishëm informativ ka edhe java e orientimit studentor që realizohet në fillim të çdo semestri.</p>			
<p>Kriteri 4. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Institucioni informon me anë të tre platformave online të sistemit të brendshëm të universitetit që janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. E-mail (adresa të posaçme të krijuara nga institucioni për të krijuar urën e komunikimit midis institucionit dhe studenteve) 2. LMS (Learning Management System, i cili shërben si një database personal për çdo student që dëshiron të informohet mbi silabuset e lëndeve që frekuenton, leksionet, informimin e krediteve, notave, tipologjive, mesatares, por dhe dorëzim online në LMS i detyrave praktike.) 3. UMS (University Management System shërben për të azhurnuar listat e notave gjithashtu përmban informacionet bazë kredenciale të çdo studenti.) 4. Website zyrtar i UET (informacion mbi programin e studimit dhe stafin akademik të çdo departamenti) <p>Keto forma informimi dhe platforma janë lehtësisht të aksesueshme jo vetëm në ambientet e UET por edhe në distancë nëpërmjet kompjuterit dhe smartphone.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional,

¹⁷⁸ Silabusi i praktikës (Ref. Nr. 19); ANEKS: Tabelat përmbledhese – Tabela Nr. 5.3

nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit.</p>	<p>UET disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit Diplomë Profesionale ne Dizajn i Aplikuar dhe Mode¹⁷⁹. Nëpërmjet Zyrës së zhvillimit të karrierës dhe Shoqatës Alumni, në mënyrë periodike mbahen kontakte të vazhdueshme me ish-studentë me qëllim jo vetëm ndarjen e eksperiencave dhe arritjeve profesionale të gjithsecilit por edhe krijimin e urave efektive lidhëse midis universitetit dhe tregut të punës.</p> <p>Ne programet e studimit qe ofron Departamenti i Arteve te Aplikuar¹⁸⁰, jane diplomuar vetem nje brez i studenteve. Brezi i radhes do te jene te diplomuarit e vitit akademik 2020-2021. Per cdo brez te diplomuarish, UET mban statistika vjetore per cilesine ne hyrje dhe ne dalje.¹⁸¹</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Universiteti mban rekorde të detajuara në lidhje me studentët e regjistruar, studentët e transferuar, ata që kanë ndërprerë studimet për një periudhë afatshkurtër, ata që janë çregjistruar, si edhe studentët e diplomuar për program studimi. Perpunimi i këtyre statistikave behet edhe me i mundshem per shkak te sistemit elektronik te menaxhimit te universitetit LMS, i cili edhe ne kete drejtim deshmon per efektivitetin dhe eficencen e perdorimit duke qene se i gjithe perparimi akademik i studenteve shoqerohet me lenien e gjurmeve ne kete sistem.¹⁸² Zyra e Karrierës dhe Praktikave mban kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventual të tyre.</p>	<p>Zyra e Kujdesit ndaj Studentit ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar konsulencë për çështje akademike dhe studentore. Ky shërbim ofrohet krahas këshillimit akademik që jepet nga personeli akademik gjatë orëve të tutoriatit dhe këshillimit akademik.¹⁸³</p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit (soft copy dhe hard copy) dhe janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. IT dhe sekretaria nepermjet UMIS. Gjithashtu në proçes ndihmon edhe sistemi UET-LMS. UET ruan dhe përpunon të gjitha të statistikat në lidhje me</p>

¹⁷⁹ Tabele permbledhese per punesimin real te studenteve (Ref. Nr. 29)

¹⁸⁰ Te dhena per numrin e programeve qe ofron njesia pergjegjese (Ref. Nr. 26)

¹⁸¹ Cilesia ne hyrje dhe ne dalje per programin (Ref. Nr. 27)

¹⁸² Cilesia ne hyrje dhe ne dalje per programin (Ref. Nr. 27)

¹⁸³ Mbi tutoriatin dhe keshillimin akademik (Ref. Nr. 27.2);

	<p>regjistrimet, ç' regjistrimet, ekuivalentimet, aplikimet për student, personelin akademik ose të shërbimit dhe kryen përpunimin statistikor të të dhënave, analizën grafike të tyre. Zyra e Kontratave kryen funksione që lidhen me procese të Sekretarisë Mësimore, si më poshtë:</p> <p>Bën regjistrimin paraprak të studentit dhe ndjek në vijimësi plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin e studentit;</p> <p>Përgjigjet për pajisjen e tyre çdo studenti me numrin përkatës të matrikullimit dhe bën hedhjen e numrave të matrikullimit në sistemin UMIS. Plotëson në mënyrë elektronike të dhënat personale dhe ato akademike të studentëve të regjistruar në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit të Universitetit (UMIS).</p> <p>Kujdeset përplotësimin dhe mban dosjet e studentëve të regjistruar në UET. Dërgon në arkiv dosjet e studentëve që kanë përfunduar studimet ose janë larguar nga UET. Çdo detyrë tjetër, që lidhet me lidhjen e kontratës së regjistrimit dhe fitimin apo humbjen e statusit të studentit në UET.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Që nga viti 2009 kur u diplomuan studentët e parë, në UET është ngritur edhe shoqata Alumni, me përfaqësuesit e secilës zhvillohen takime të vazhdueshme për të vjelur mendime në lidhje me përmirësimet e mundshme që do të duhet të bëhen në organizimin dhe ofertën akademike të institucionit për t'iu përshtatur më mire kërkesave të tregut të punës dhe zhvillimeve bashkëkohore në Europë e më gjerë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>UET parashikon dhe ka kontretizuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë Universitetit. Studentët organizohen në Keshilli Studentor, në fokus grupet e vlerësimit të lëndëve dhe pedagogëve, nëpërmjet vlerësimit online për pedagogun etj. Studentët përfshihen gjithashtu edhe në Senatin</p>

	Akademik të UET, Dekanat, Këshillin e Etikës, dhe në Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. ¹⁸⁴
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	<p>Një herë në muaj departamenti kryen mbledhje të hapura. Studentë të departamentit të viteve të ndryshme ftohen të marrin pjesë në këtë mbledhje ku diskutojnë me pedagogët, për të kontrolluar mbarëvajtjen e studimeve dhe për të shprehur të gjithë mendimet apo problematikat e tyre (referuar nenit 22, pika 2 e Rregullores Mësimore UET)¹⁸⁵. Gjithashtu përpara përfundimit të semestrit studentët bëjnë vlerësimin anonim të pedagogëve me të cilët kanë zhvilluar mësim. Ky vlerësim bëhet elektronikisht, nëpërmjet sistemit LMS, me një varësi pyetjesh mbi cilësinë e zhvillimit të mësimin nga pedagogu, apo cilësinë e literaturës ku bazohet lënda, gatishmërinë e pedagogut për të ndihmuar studentët në përmbushjen e detyrimeve të lëndës, apo për t'i sqaruar në lidhje me rezultatet e vlerësimit të përvetësimit të dijeve.</p> <p>Një mënyrë tjetër janë dhe “Focus Group”. Rezultatet përpunohen dhe u bëhen të ditura drejtuesve të universitetit dhe vetë pedagogëve, pasi të jenë mbyllur procesverbalet e vlerësimit të studentëve, me qëllim që rezultati të mos ndikojë në vlerësimin e tyre.</p>
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	<p>Referuar pikes D.II., Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin e studentëve, Broshura e dokumenteve në zbatim të statutit dhe të rregullores bazë të UET-it. Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, udhëzimeve përkatëse të MAS-it dhe në përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës, Universiteti European i Tiranës, pranon transferime të studentëve në vitet ndërmjetëse nga shkollat e tjera të larta, vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të tij në shkolla të tjera të larta, sipas procedurave të parashikuara në këtë dokument. Në çdo rast studenti duhet të ndjekë në UET, jo më pak se 25% të ECTS-ve teorike, si dhe diplomën dhe praktikën profesionale.</p> <p>Gjithashtu dhe ngarkesa mesimore paraqitet e balancuar, per kete Departamenti bazohet ne aktet nenligjore perkatese. Ngarkesa e oreve ne auditor per vitin e pare eshte 575 ore, kurse per vitin e dyte 593, pra ne total 1168 kundrejt ngarkeses totale prej 3000 oresh.¹⁸⁶</p>
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e	Përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe

¹⁸⁴ Urdher administrative mbi perberjen e KSBC (Ref. Nr. 30.4); Te dhena per individet e angazhuar ne KSBC (Ref. Nr. 30)

¹⁸⁵ Rregullore e UET, neni 22, pika 2. (Ref. Nr. 5)

¹⁸⁶ Plani mesimor I programit te studimit (Ref. Nr. 14.1)

<p>hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>përmirësimit të programeve të studimit realizohet përmes Pyetësorit me studentët. Pyetësori organizohet dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet e studimit, për të gjitha ciklet, për të gjitha lëndët dhe pedagogët.¹⁸⁷ Ndër elementët që vlerësohet është edhe silabusi i lëndës. Gjithashtu edhe takimet e drejtuesve të institucionit me studentët, tërheqja e mendimit nga “fokus grupet” si edhe pyetësorët me frekuencë simestrale apo mbi një problem specifik, tërhiqin mendime të studentëve mbi çdo program studimor në tërësi, mbi çdo lëndë të veçantë dhe çdo pedagog.</p> <p>Forme tjeter e përfshirjes se studenteve eshte nëpërmjet angazhimit periodikisht në mbledhjet e hapura të departamentit, studentët kanë mundësinë të përfshihen në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit, nëpërmjet sugjerimeve të ndryshme që ata bëjnë herë pas here. Gjithashtu ata mund të japin mendimet online në çdo moment nëpërmjet UET LMS dhe Microsoft Teams, dhe duke komunikuar direkt me departamentin përkatës.</p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Për një gjykim dhe vlerësim sa më objektiv të njohurive dhe formimit akademik, studentëve u mundësohet të çojnë për rishikim tezhën pas përfundimit të periudhës sezonale duke qenë se institucioni e ka pjesë të saj seancat sqaruese në të cilat studentët mund të rishikojnë dhe rianalizojnë dhe njëherë tezat përkatëse së bashku me pedagogun përkatës.¹⁸⁸</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.5 Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Njësia e posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve në UET është zyra e Kujdesit ndaj Studentit. Kjo zyrë ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar konsulencë për çështje akademike dhe studentore. Po ashtu njoftime te vazhdueshme studenteve u komunikohen nga Koordinatorët e Fakulteteve.</p>

¹⁸⁷ Formati i vlerësimit te pedagogut nga studentet (Ref. Nr. 40)

¹⁸⁸ Rregullore mesimore e programit te studimit (seksioni 5.8: Kërkesa per rivleresim) (Ref. Nr. 7)

<p>Kriteri 2. Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>UET ka një sistem të posaçëm për mirëpritje (zyra e pranimeve) informimin, këshillimin, ndjekjen, asistimin (Zyra e kujdesit ndaj studentëve, Zyra e zhvillimit të karrieres, Zyra e projekteve dhe partneriteteve) (këshilluesit akademik, sekretaria mësimore, kordinatorët e departamenteve, regjistruarit e lëndëve, etj) e studentëve për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Kjo bëhet kryesisht nëpërmjet zyrës së kujdesit ndaj studentëve, si edhe njësisë të tjera, por edhe me anë të sistemit UET LMS dhe Microsoft Teams ku ofrohen informacione të përditësuara për procesin mësimor dhe programin e studimit. Informimi i studentëve realizohet edhe nëpërmjet email-it, që shërben si një mjet tjetër për informim dhe këshillim nga individët dhe njësitë përgjegjëse.</p>			
<p>Kriteri 3. Përmes zyrës/njesisë për këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Në UET funksionon zyra për këshillimin e karrierës dhe (zyra për kujdesin ndaj studentit) të cila ofron në mënyrë të vazhduar dhe periodike informacion dhe orientim të posaçëm, këshillim të karrierës, informacion i lidhur me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera, si edhe orientim në lidhje me tregun e punës¹⁸⁹.</p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre.</p>	<p>Zyra për këshillimin e karrierës dhe Shoqata Alumni ndjekin studentët pas diplomimit duke mbledhur, përpunuar dhe mbajtur të dhëna mbi punësimin e studentëve të programit të studimit ¹⁹⁰ dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse, dhe në kuadër të funksionit të saj¹⁹¹ merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre, nëpërmjet kontakteve dhe bashkëpunimit me organizatat partnere të UET. Feedback-u në lidhje me këto çështje u kalohet në mënyrë të veçantë studentëve por edhe organeve drejtuese të UET.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

¹⁸⁹ Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit (Ref. Nr. 12)

¹⁹⁰ Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Ref. Nr. 29)

¹⁹¹ Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit (Ref. Nr. 12)

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional në “Dizajn i Aplikuar dhe Modë” të Institucionit të Arsimit të Lartë, Universiteti European i Tiranës

Pikat e forta dhe afirmime

1. Që prej ngritjes së tij në vitin akademik 2018 - 2019, Departamenti i Arteve të Aplikuara ka pasur në përbërjen e tij një trupë pedagogjike të përbërë nga personalitete nga fusha e arteve të cilët kanë qenë dhe mbeten protagonistë në zhvillimet e sotme artistike dhe kulturore, jo vetëm në krijimtari por edhe sa i përket hulumtimit dhe kërkimit shkencor. Angazhimi i tyre akademik përkon edhe më ofrimin e një infrastrukture të përshtatshme për të zhvilluar veprimtarinë e tyre akademike. Në të njëjtën kohë projektimi dhe zbatimi i një sërë projektesh të rëndësishme si ato me partneritet shqiptar, ashtu edhe ato me mbështetje dhe partneritet ndërkombëtar, ndikojnë në përmbushjen e të gjitha objektivave të përcaktuara dhe të synuara nga departamenti. Gjithashtu, organizimi i një sërë veprimtarish artistike dhe kulturore në universitet, ku studentë dhe pedagogë performojnë së bashku për publikun e pranishëm, ndikon në praktikimin dhe marrjen e përvojës së drejtpërdrejtë në krahasim të emrave dhe personaliteteve të shquara të artit dhe kulturës shqiptare.
2. Kurrikula e programit të ofruar është konform kërkesave reale të tregut të punës në fushën e dizajnit, modës, dhe arteve pamore. Programi krijon mundësi që studentët të zhvillojnë kreativitetin, shprehinë artistike. Formimi praktik artistik komplementohet me bazën e shëndoshë teorike.
3. Staf i akademik është i kualifikuar dhe me përvojë në fushat përkatëse. Ky është faktor i rëndësishëm në mësimdhënie, dhe rrejdhimisht në formimin akademik të studenteve të programit. Disa prej personaliteteve të kulturës shqiptare janë gjithashtu pedagogë të programit.
4. Fakulteti, Departamenti që ofron këtë program dhe UET kanë lidhur marrëveshje me institucione dhe biznese të ndryshme për praktikën profesionale të studentëve në përfundim të studimeve të tyre. Zbatimi i një sërë projektesh të rëndësishme si ato me partneritet shqiptar, ashtu edhe ato me mbështetje dhe partneritet ndërkombëtar, ndikojnë në përmbushjen e të gjitha objektivave të përcaktuara dhe të synuara nga departamenti. Bashkëpunimi me institucione dhe subjekte të njohura si Teatri Kombëtar, Kompania Filmike AA, Qendra Kombëtare e Librit, Mediat e ndryshme si Top Channel, Radio Televizioni Publik Shqiptar, "48 Hour Film Projekt", Kënga Magjike apo me studio të ndryshme picture, dizajni dhe atelie të modës e kanë rritur së tepërmi mundësinë dhe hapësirën e zbatimit të një programi të detajuar ku studenti përveç anës teorike, ushtrohet dhe aftësitë e tij promovohen edhe në skenë apo në ambientet më të njohura artistike në vend.
5. UET dhe Departamenti i Arteve të Aplikuara zhvillojnë vazhdimisht aktivitete fromuese dhe promovuese në benefit të studentëve, si dhe takime të ndryshme me personalitete të fushave të Artit, gjë që ndikon pozitivisht në formimin e njohurive dhe krijimin e përvojave të reja në krijimtarinë artistike të studentëve. Angazhimi i stafit pedagogjik dhe studentëve nëpër projekte të ndryshme, në partneritet me shkollën por edhe përtej (si program Erasmus+ apo trajnimet që ofron shkolla), krijon përvoja të reja arsimore, gjë që ndikon pozitivisht në marrëdhënien student-pedagog, dhe rrjedhimisht në formimin më të kompletuar akademik të studentëve.

6. Teknologjia bashkëkohore në edukim, e ofruar si në auditorët / mjediset e shkollës, ashtu edhe online ka ndihmuar së tepërmi në shpjegim, ndëveprimin midis studentëve dhe pedagogëve dhe vijueshmërinë e seanceve mësimore edhe në rastet kur studentët ndodhen larg. Mësimdhënia online ka shfaqur shenja suksesi sidomos në rastin e lëndëve teorike (të Tipologjisë II).

Pika të dobta

1. Fazat nëpër të cilat nisi punën dhe vijoi konsolidimin e tij Departamenti i Arteve të Aplikuara përkoi edhe me përhapjen e pandemisë Covid 19 dhe respektimin e masave dhe protokolleve ku veprimtaria artistike dhe kulturore pësoi një kufizim dhe në pjesën më të madhe pezullim të veprimit të saj. Si pasojë studentët patën vështirësi të dukshme në zhvillimin e praktikave profesionale, pasi krejt veprimtaria e subjekteve publike dhe private e ndryshoi qasjen e saj ndaj publikut. Si rrjedhojë në teatrin kombëtar u pezulluan shfaqjet në të cilat ishte projektuar që një pjesë e studentëve të merrnin pjesë në realizimin e skenave masive apo edhe në role të vogla episodike. Në të njëjtën kohë nuk ushtruan funksionin e tyre studiot e pikturës dhe atelietë e modës, duke mos u organizuar ekspozita dhe sfilata të modës, në të cilat ishte parashikuar pjesëmarrja e studentëve tanë si në drejtim të organizmit ashtu edhe sa i përket performancës. Në të njëjtën kohë, studiot muzikore, nuk mundën që të zbatonin planet e tyre për interpretime live për publikun e gjerë ku një pjesë e studentëve, ishin përcaktuar që të përfshiheshin në programe të ndryshme gjatë sezonit pranveror dhe atij veror por disa syresh mundën vetëm të regjistronin dhe të publikonin hite të ndryshme të shfaqura në platforma elektronike dhe në rrjete sociale, gjë e cila e kushtëzoi së tepërmi marrëdhënien e drejtpërdrejtë me skenën dhe me marrjen e përvojës për organizmin dhe angazhimin me kohë të plotë në projekte apo programe specifike.
2. Pavarësisht statistikave indikatorëve të ndryshëm mbi profesionet e fushave të artit, tregu i punës kërkon disi më shumë kohë për t'u mësuar me kërkesat për diploma profesionale në raport me ato Bachelor.
3. Pavarësisht përparimeve në teknologjinë e arsimit global, e implementuar tashmë edhe në UET, për disa prej lëndëve praktike (të Tipologjisë I) është absolutisht e nevojshme që të zhvillohen në atelje, laboratorë, apo auditorë për të arritur cilësinë e nevojshme dhe rezultate optimale në zhvillimin e mësimin. Pra, mund të themi se teknologjia nuk mund të zëvendësojë gjithçka.

Lista e dokumenteve mbështetëse për procesin e akreditimit të programit të studimit me karakter profesional në “Dizajn i Aplikuar dhe Modë”

1. Mendimi i Dekanit
2. Statuti i UET
3. Plani Strategjik UET 2015-2020
 - 3.1. Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020
 - 3.2. Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025
 - 3.3. Plani Strategjik UET 2021-2025
4. Plani Strategjik për zhvillimin e programit
5. Rregullore e UET
 - 5.1 Vendim_Mbi zhvillimin e procesit akademik ne situaten e krijuar nga pandemia COVID-19 dhe Mbi lëshimin e diplomave
 - 5.2 Rregullore tranzitore_Mbi vijimin e procesit akademik gjatë semestrit të parë të vitit akademik 2020-2021 në kushtet e pademisë COVID-19
 - 5.3 Rregullore tranzitore_Per zhvillimin e procesit akademik gjate Vitit Akademik 2020-2021
6. Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit
7. Rregullore e programit të studimit DP Dizajn i Aplikuar dhe Modë
 - 7.1. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve
 - 7.2. Formati i tezës së provimit përfundimtar
8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë
9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore
10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit
 - 10.1. Kalendari akademik 2018-2019
 - 10.2. Kalendari akademik 2019-2020
 - 10.3. Kalendari akademik 2020-2021
11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore
 - 11.1. Shembull thirrje për staf akademik
12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit
 - 12.1. Bordi i Tregut të Punës
 - 12.2. Poster_Panairi i punës 2018 dhe 2019
 - 12.3. Realitetet e Reja të Post-Covid 19 në Tregun e Punës 2020
 - 12.4. Takime_aktivitete Bordi i Tregut të Punës
13. Dokumenti E.VIII Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave
14. Kurrikula e programit DP Dizajn i Aplikuar dhe Modë
 - 14.1. Plani mësimor i programit
 - 14.2. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – DP Dizajn i Aplikuar dhe Modë
 - 14.3. Plani mësimor sipas veprimtarive me karakter teorik v.s. praktik
15. Modeli i diplomës (**Urdhëri i aprovimit – urdhër nuk ka, pritet akreditimi**)
16. Argumentimi për hapjen e programit
 - 16.1 Analizë e DAA e tregut të punës para hapjes: Prespektiva punësimi
17. Studimi (periodik) për tregun e punës, pas daljes së studentëve
18. Adresimi i rekomandimeve të hapjes

19. Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite
 - 19.1. Formati i Syllabusit
20. CV e stafit akademik të programit të studimit
21. CV e stafit akademik udhëheqës i diplomave (në rastin kur nuk është pjesë e stafit akademik të programit **(nuk ka)**)
22. CV e stafit ndihmës akademik **(nuk ka)**
23. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse
24. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit ndër vite (Aneks Tabela 6)
25. Ngarkesa mësimore në auditor e stafit akademik, të angazhuar në programin e studimit (Aneks Tabela 4)
26. Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga njësia përgjegjëse
27. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin
 - 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve
 - 27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik
28. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin
29. Tabelë përmbledhëse për punësimin real të studentëve
30. Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC
 - 30.1. Plani veprimit KSBC
 - 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë
 - 30.3. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë
 - 30.4. Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC
 - 30.5. Metodologjia e punës së aktiviteteve të KSBC
 - 30.6. Format_Raporti për provimet
 - 30.7. Shpërndarja e relacionit të KSBC mbi silabuset
 - 30.8. G-III-4-1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu
 - 30.9. Fisha e projektit Enchase
 - 30.10. Fisha e projektit QAinAL
31. Të dhëna për kodifikimin e programit të studimit (mbështetur në LAL 80/2015), apo Udhëzimeve Kombëtare e Europiane **(nuk kanë dalë ende aktet nga MASR)**
32. Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale (informacion shtesë: Aneks Tabelat 5)
 - a. Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale
 - b. B-I-4 Formulari i vetëvlerësimit të praktikës (nga Studenti)
33. Të dhëna për trajnimet profesionale
 - 33.1 Kalendar i aktiviteteve
34. Marreveshje bashkëpunimi:
 - 34.1 Memorandum Bashkëpunimi mes UET dhe WE WEB\
 - 34.2 Marreveshje Bashkëpunimi mes EEI & Balfin
 - 34.3 Marreveshje Bashkëpunimi mes UET dhe ITD
 - 34.4 Marreveshje Bashkëpunimi mes UET dhe The Plaza Tirana
 - 34.5 Memorandum Bashkëpunimi mes UET dhe E.H.W

- 34.6 Marrëveshje Bashkepunimi mes Qendra Kulturore Tirane dhe UET
- 34.7 Listë e marrëveshjeve të bashkëpunimit UET
- 34.8 Marrëveshje UET dhe Instituti i Modës “KAÇELI”
- 34.9 Marrëveshje bashkëpunimi UET_ Universiteti Arteve
- 34.10 Memorandum bashkëpunimi UET dhe Createur Studio
- 34.11 Memorandum bashkëpunimi UET_Greiss Petroviq
- 34.12 Memorandum bashkëpunimi UET OnOff
- 35. Raporti i fundit analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit
- 36. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit (**legjislacioni nuk parashikon Koordinator të programeve të studimit me karakter profesional**)
- 37. Format relacioni për vlerësimin e përputhshmërisë së silabuseve
- 38. Analiza e departamentit përgjegjës
- 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës
- 40. G-III-4-2 Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët
 - 40.1 D-VI-3-3 Formular për ankesat e studentëve
- 41. G-I-12-1 Formular i vetevlerësimit të performancës së personelit akademik
- 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit
- 43. Aktivitetet dhe veprimtaritë krijuese/artistike të stafit akademik & përfshirja e studentëve 2018-2020
 - 43.1 Të dhëna mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit dhe studentëve
 - 43.2 Raportim i punës krijuese artistike dhe kërkimore shkencore_DAA 2018-2021
- 44. Format Dosje staf akademik (**administrohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore, sipas PAK/PAE**):
 - 44.1 Format dosje staf akademik me kohë të plotë
 - 44.2 Format dosje staf akademik me kohë të pjesshme
- 45. Inventari i teksteve për fushën e programit të studimit DP Dizajn i Aplikuar dhe Modë
 - 45.1 Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës
 - 45.2 E-IV-2 Formular për pasurimin e fondit të librave në bibliotekë
 - 45.3 Shembull procedure_blerje literature
- 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS
 - 46.1 Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS
 - 46.2 UET LMS Guide për pedagogun
 - 46.3 UET LMS Guide për studentet
 - 46.4 Video-trajnime mbi sistemin TEAMS/LMS

46.5 Raport: ecuria e mësimit online

47. Faqja zyrtare e Universitetit European të Tiranës www.uet.edu.al; <https://uet.edu.al/new/fakulteti-i-shkencave-humane-edukimit-dhe-arteve-liberale/?lang=sq>
48. Dokumenti E.V. Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online;
49. Të dhëna mbi koston për student (Aneks Tabela 18.1)
50. Të ardhura dhe financime të ndryshme (Aneks Tabela 18.2)
51. Politika e marketingut të programit të studimit
52. Procedura për ndryshimin e kurrikulës (**Nuk ka – program i ri**);
53. Ligji 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH”
 - 53.1 VKM Nr. 41, datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit”, e ndryshuar
 - 53.2 VKM Nr. 531, datë 11.06.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”
54. UMASR Nr. 555, datë 11.09.2018 “Për hapjen e programit Dizajn i Aplikuar dhe Modë, UET”
 - 54.1 VKM Nr. 636, datë 20.09.2006 “Për hapjen e UET”
 - 54.2 UMASR Nr. 528, datë 04.09.2018 “Për riorganizimin e FSHHEL në UET”
 - 54.3 VBA Nr. 12, datë 07.04.2017 “Për akreditimin institucional të UET”
 - 54.4 VBA Nr. 46, datë 05.07.2019 “Për akreditimin e UET”
 - 54.5 Certifikatë Akreditimi UET
55. A.II. Kodi i Etikës